



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti: Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

Vlerat estetike të veprës së Fishtës

KANDIDATJA:

Adelinë Kafexholli-Zekolli

MENTORI:

Prof.dr.Zeqir Kadriu

Tetovë, 2018

ABSTRAKT

Ndonëse objekt i këtij studimi janë vlerat estetike të veprës së Fishtës në përgjithësi, vlerësimet që i janë bërë nga autorë të tjerë dhe studimi i veprës së tij kombtare “Lahuta e Malcisë”, me elemente estetike që shtrihen gjithkund nëpër të, është e nevojshme të thuhet se Fishta u mor vetë me problemet estetike, me vlerësime estetike, madje shkroi edhe veprën “Shinime estetike”.

Në këtë punim përmenden gjithashtu emrat e filozofëve, estetëve dhe artistëve të cilët Fishta kishte mbështetur mendimin estetik, gjegjësisht emrat të cilët e kishin ndihmuar të formohej si estet, siç ishin: Platoni, Aristoteli, Demosteni, Ciceroni, Taine dhe kompozitorët e njohur: Bah, Mozart, Beethoven, të cilët e mbështet estetikën e artit muzikor, por të bukurën dhe vlerat e tjera të estetikës së letërsisë i ka marrë nga shkrimtarët e mëdhenj. Homerin e çmonte më së shumti nga të gjithë shkrimtarët e tjerë. Në veprat e tij, “Iliada” e “Odisea” ai pa vlerat estetike: të bukurën njerëzore (Helena, Paridi etj.), të bukurën natyrore (përshkrimet nga të dyja veprat e sidomos të “Odisea”), të bukurën shpirtërore, si: urtësinë, burrërinë, mëshirën të njerëzimit me karaktere të ndryshme, (Nestori e Priami); të madhërishtmen në veprat e heronjve që i kapërcejnë kufijtë realë (Akili, Hektori, Odiseu) dhe bëjnë ndonjëherë edhe të pamundshmen, siç janë aventurat e Odiseut. Trimërinë me vlera estetike si kategori e heroikës që i përshkon të dyja veprat, Fishta i bart te heronjtë e “Lahutës së Malcisë” bashkë me një pasuri të madhe të qenieve mitologjike. Po aty gjejmë edhe skena dhembjeje, si: vrasje, djegie, shkatërrime, që e karakterizojnë tragjikën, (vrasja e Hektorit, po edhe e Akilit që ka një domethënie të veçantë). Po nuk mungon as akti i tradhtisë (kali i Trojës) dhe dukuri të tjera të ulëta që sjell lufta.

Gjithashtu një mbështetje të fuqishme gjeti tek Virgjili, Danteja, Petrarka (portretizimet e bukurisë) e deri te veprat e shkrimtarëve të kohëve më të vona që i përmend dhe që i shërbejnë si modele letrare konkrete, si “Vdekja e Smail Agë Çengiqit” e Mazhuraniqit dhe “Kurora e maleve” e Njegoshit. Gjithashtu nuk harron Shekspirin, Gëten, Hajnen, Leopardin, Kalderonin e të tjerë. Janë këto figura të shquara të artit e filozofisë që ndikuan në formimin e tij prej esteti të letërsisë dhe të filozofisë.

Fjalë kyçe: Estetika, Fishta, E bukura, Lahuta e Malcisë, Jeta dhe vepra, etj.

MIRËNJOHJE

Punimi i diplomës i ngjan një udhëtimi të gjatë e të vështirë, por që të fal edhe shumë kënaqësi. Ky udhëtim i gjatë do ishte edhe më i vështirë nëse nuk do kisha mbështetjen e shumë njerëzve, të cilët kontribuan në finalizimin e qëllimit tim për tu diplomuar. Prandaj dëshiroj të falenderoj të gjithë ata që më mbështeten në realizimin e këtij punimi.

Një falenderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim në këtë punim Prof.dr.Zeqir Kadriu, e falenderoj për këshillat dhe sugjerimet e vazhdueshme, e mbi të gjitha për mbështetjen morale dhe qetësinë e transmetuar tek unë gjatë gjithë kësaj kohe. Ishte privilegj për mua të punoj me ju për realizimin e këtij punimi.

Së fundi,dëshiroj të ju shpreh mirnjohjen time të thellë familjes sime pa mbështetjen e të cilës realizimi i këtij punimi nuk do kishte qënë i mundur. Falë dashurisë, mbështetjes dhe nxitjes së të cilëve dëshira ime u realizua!

Dhe një falenderim i vecant shkon për bashkëshortin tim, për mbështetjen kurajon për lehtësitë e mëdha që më ofroi, si dhe që më krijoi të gjitha mundësitë për ta realizuar gjithë këtë rrugëtim të gjatë !

TABELA E PËRMBAJTJES:

ABSTRAKT	2
MIRËNJOHJE	3
KAPITULLI I - HYRJE	
I.1. Sfondi i hulumtimit.....	6
I.2. Qëllimet e hulumtimit.....	8
I.3. Hipotezat.....	8
I.4. Metodologjia e hulumtimit.....	8
I.5. Rëndësia e punimit.....	8
I.6. Struktura e hulumtimit.....	9
KAPITULLI II - FISHTA, VEPRIMTARIA DHE SHKRIMI ESTETIK I FISHTËS	
II.1. JETA DHE VEpra	11
II.1.1. Jeta	11
II.1.2. Vepra	12
II.2. SHKRIMET ESTETIKE TË FISHTËS	17
II.3. KONCEPTET ESTETIKE TË FISHTËS	19
II.3.1. E bukura dhe e mira në natyrë	19
II.3.2. E Bukura dhe e Pëlqyeshmja	21
II.3.3. E Bukura që ngjallitë artin	21
II.3.4. Arti nuk është imitim	22
II.3.5. Vepra artistike-botë më vete	23
II.3.6. Teoria e dy Rruzullimeve	24
II.4. KRAHASIME PËRGJITHËSUESE TË FISHTËS ME MENDIME TË TJERA ESTETIKE-KRITIKE	27
II.4.1. Hyrje e shkurtër për mendimin estetik Shqiptar.....	27
II.4.2. Krahasime përgjithësuese të Fishtës me Pjetër Bogdanin	30
II.4.3. Krahasime përgjithësuese të Fishtës me Jeronim De Radën	30
II.4.4. Fishta dhe kritika letrare e Konicës	34
II.4.4.1. Metoda e gjykimit: hapja e letërsisë shqipe ndaj letërsisë botërore	35
II.4.4.2. Letërsia dhe Atdheu	36
II.4.4.3. Kritika himnizuese dhe kritika vlerësuese	37

II.4.4.4. Metoda e kritikës letrare-kritika moderne si mohim i kritikës biografiste	38
KAPITULLI III - SHËNIME ESTETIKE DHE ESTETIKA E FISHTËS NË VEPRËN “LAHUTA E MALCISË”	
III.1. SHINIMET ESTETIKE TË FISHTËS.....	41
III.2. ANALIZË ESTETIKE E LAHUTËS SË MALCIS TË GJERGJ FISHTËS	45
III.2.1. Si lindi Lahuta e Malësisë	45
III.2.3. Lahuta e Malcis	46
III.3. VLERAT ESTETIKE TË “LAHUTA E MALCIS”	51
III.4. VLERËSIMET PËR LAHUTËN E MALCIS DHE PËR FISHTËN	55
III.4.1. A qëndron vlerësimi i Ismail Kadaresë për Lahutën e Malësisë?.....	61
IV. PËRFUNDIME	66
V. LITERATURA	68

KAPITULLI I. HYRJE

I.1. Sfondi i hulumtimit

Një paraqitje sa më e plotë e shpirtit të një populli, një pasqyrim sa më i saktë i personalitetit të tij, kërkon të trajtohen edhe probleme të tilla, si: sa dhe si e kupton dhe e vlerëson ai të bukurën dhe kategoritë e tjera të estetikës në natyrë, në jetë dhe në art; çfarë e dallon atë ose çfarë të veçante ka ai në këtë fushë të psikës së tij në krahasim me popuj e kombe të tjera, cili është individualiteti i tij në fushën e estetikës.

Teorikisht, estetika është teoria e kuptimit të botës dhe e përjetimit të saj nëpërmjet ndjenjave e shqisave, çka është një njohje intuitive, përmes së cilës njeriu kupton dhe vlerëson kategoritë e estetikës: të bukurën, të shëmtuarën, tragjiken, komiken, heroiken, të ultën, etj.

Nevojat, shtysat, synimet e shpirtit të njeriut, përcaktuar nga Platoni janë: e vërteta, e mira, e bukura. Ideali dhe synimi ndaj së vërtetës është i pashmangshëm, i padiskutueshëm. Ka mendimtarë që të mirën e vlerësojnë si imperativ të parë të jetës shpirtërore të njeriut, si mjetin e parë për zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë njerëzimin. Duke folur për rëndësinë e etikës në proceset e zhvillimit shoqëror, filozofi francez Paul Ricour, ka thënë: “...në erën globale ajo kthehet në mjetin e vetëm të orientimit”. Edhe në mendimin shqiptar është shtruar ky problem: “Sfida jonë në fillim të shekullit XXI asht krijimi i bashkësisë etike shqiptare, e cila ka si qëllim të vetin të mirën e përbashkët dhe jo interesat e përveçme.”, ka shkruar Ardian Ndreca.

Historia e filozofisë dhe e estetikës ka pasur edhe gjykime, sipas të cilave, bukurisë i është dhënë prioriteti i jetës shpirtërore. Shkrimtari i shquar francez, Anatole France ka thënë: “Unë besoj se ne kurrë nuk do të dimë me saktësi pse një gjë është e bukur. Askush nuk ka qenë i aftë të ma tregojë me përpikëri një gjë të tillë...Sa për mua, unë ndjek ndjenjën time për të bukurën. A mund të gjej njeriu një udhërrëfyes më të mirë?...Nëse do të më duhet të zgjedh mes së bukurës dhe së vërtetës, unë nuk do të lëkundem, do të zgjedh të bukurën. Nuk është asgjë e vërtetë në këtë botë, veç së bukurës.” Niçe i ka çmuar në shkallën më të lartën vlerat e estetikës: “Vetëm si dukuri estetike ekzistenca dhe bota janë përjetësisht të përligjura”.

Po është e domosdoshme të theksojmë këtu se e bukura është një kategori estetike a edhe një koncept i papërkufizueshëm. E themi kështu, sepse pothuajse të gjithë estetët që kanë lavruar në këtë fushë, e kanë përkufizuar atë në mënyrë të ndryshme nga njëri-tjetri. Për estetin italian Benedeto Croce, bukuria është thjesht “shprehje”. Ai shkruan: “...për të ngushtuar domethënien e fjalës “i bukur” kryesisht në vlerën estetike, na duket e lejueshme dhe me vend që bukurinë ta përkufizojmë si shprehje të realizuar si duhet ose më mirë vetëm shprehje, sepse shprehja kur s’është e realizuar si duhet, nuk është më shprehje.”

Në përputhje me idenë platoniane të treshes shpirtërore, në kulturën tonë kemi një përkufizim klasik të bukurisë, dhënë nga Anton Harapi: “Nieri provon në vete të vërtetën e të mirën, dhe ndien nevojën ta shprehë: qartësia e së vërtetës dhe e së mirës objektive, e ndieme në shpirt dhe e shprehun me forma e vepra ma të plotat: kjo asht bukuria.”

Për çdo aspekt të jetës, të natyrës, të shoqërisë, të artit, populli ynë, si çdo popull tjetër, ka pasur dhe ka mendimet e gjykimet e veta estetike, ka përjetuar dhe përjeton ndjenja dhe shije estetike, të ngjashme a të ndryshme nga popujt e tjerë. Atë e ka karakterizuar një ideal vetjak estetik, dhe në kuadrin e kulturës lëndore e shpirtërore, të krijimtarisë folklorike dhe asaj të kultivuar, ka treguar aftësi të lakmueshme në krijimin e së bukurës, duke shprehur botën e vet shpirtërore, dhe, njëkohësisht, duke dhënë ndihmesën e vet origjinale në kulturën evropiane dhe botërore.

Veçanërisht në proverbat, urtësia popullore ka sendërtuar dukuritë më të ndryshme estetike, idealet, konceptet, gjykimet, vlerësimet, ndjenjat, shijet, etj. Në qenësinë e tyre, fjalët e urta të këtij lëmi janë një ndërthurje gnoseologjike, estetike, gjithnjë edukative, dhe po aq edhe didaktike.

Në proverbin “E bukur – e përputhur” është shprehur marrëdhënia e natyrshme mes bukurisë dhe harmonisë; ndryshe: për të qenë e bukur diçka, duhet të karakterizohet nga një lidhje e natyrshme dhe e përshtatshme ndërmjet pjesëve që e përbejnë atë. Të njëjtën ide populli e ka dhënë edhe më fjalën e urtë: “Pritet petku sipas shtatit”.

Edhe në trajtime teorike theksohet harmonia si domosdoshmëri për të bukurën. Fishta ka shkruar: “Bukuria – një dritë qi buron prej harmonijet”.

I.2. Qëllimet e hulumtimit

Për çdo aspekt të jetës, të natyrës, të shoqërisë, të artit, populli ynë, si çdo popull tjetër, ka pasur dhe ka mendimet e gjykimet e veta estetike, ka përjetuar dhe përjeton ndjenja dhe shije estetike, të ngjashme a të ndryshme nga popujt e tjerë. Atë e ka karakterizuar një ideal vetjak estetik, dhe në kuadrin e kulturës lëndore e shpirtërore, të krijimtarisë folklorike dhe asaj të kultivuar, ka treguar aftësi të lakmueshme në krijimin e së bukurës, duke shprehur botën e vet shpirtërore, dhe, njëkohësisht, duke dhënë ndihmesën e vet origjinale në kulturën evropiane dhe botërore.

Veçanërisht në proverbat, urtësia popullore ka sendërtuar dukuritë më të ndryshme estetike, idealet, konceptet, gjykimet, vlerësimet, ndjenjat, shijet, etj. Në qenësinë e tyre, fjalët e urta të këtij lëmi janë një ndërthurje gnoseologjike, estetike, gjithnjë edukative, dhe po aq edhe didaktike. Pikërisht për këtë arsye qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë trajtimi i koncepteve estetike të autorit të përzgjur Gjergj Fishta, si një nga më të veçantët e në këtë fushë.

I.3. Hipotezat

Hipoteza gjenerale: Vlerat estetike të veprës së Fishtës në përgjithësi dhe veprës së tij madhore “Lahuta e Malcis” në veçanti, e bëjnë Fishtën një ndër studiuesit më të rëndësishëm të estetikës në fondin e Gjuhës Shqipe.

I.4. Metodologjia e hulumtimit

Për tu pregaditur ky punim janë përdorur këtë metoda:

1. Metodën teorike;
2. Metodën komparative (krahasuese);
3. Metodën deskriptive; dhe
4. Metodën analitike.

I.5. Rëndësia e punimit

Për të shprehur rëndësinë e këtij studimi, duhet në rradhë të parë të trajtojmë rëndësinë e Fishtës për gjuhën dhe kombin Shqiptar, e ku më mirë se përmes fjalëve të Koliqit mund ta shprehim atë: “Tue lexue Lahutën e tij, (të Fishtës – Xh.Z.) përplot me teprica kangësh rapsodike të pa emën, të duket se je tu e vështruar popullin shqiptar kah i këndon vedvetit, me fjalët e Fishtës, ma të kulluetën kangë, e cila shpërthen nga një gjak misterioz, që rrjedh në zemrën e tij ilire”.

Kur flasim për Fishtën, mendja na vete menjëherë te vepra e tij madhore “Lahuta e Malcis”. Ndonëse janë bërë studime nga më të ndryshmet për veprën e tij nga emra të njohur, që e nderojnë shkencën e letërsisë, ndonëse edhe autori i këtyre rreshtave ka bërë një studim të mirëfilltë mbi estetikën dhe konceptet e estetikës nga Fishta, mendojmë se nuk është thënë e tëra. Mendojmë se ky dimension jo vetëm i kësaj vepre të tij por dhe ajo “Shinime Estetike” gjithnjë të nxisin për të thënë diçka të re, sepse krijojnë ndjenja të veçanta estetike.

Ndërsa i rikthehemi “Lahutës së Malcis” duke krijuar ndjesi dhe ndjenja të tjera estetike. Për t’i çelur portat e artit letrar dhe vlerat estetike, duhet hapur perdja e E. Koliqit që na e nxjerr përpara bukurinë dhe madhësinë e veprës: “Ndëgjoje hapin kumbues t’Oso Kukës kah i bjen pash e në pash Pazarit të Shkodrës, ndigjoi troket e dhënve e të dhive të Marash Ucit e të bijve të Colit që kullosin nëpër bjeshkë, vënja veshin ligjirimit të flatruem t’Abdyl Frashërit në Kuvend të Lidhjes së Pezrendit edhe vajit t’Orëve e të zanave mbi trupin e pashpirt të Tringës së vrame prej anmikut, lëshoju në rrëmbim të vargjeve tingullore edhe Shqipnija, me male e me fusha, me pyje e proje ka për të hy mbrendë në dhomë prej dritareve të hapuna”. (26, 61)

Bashkëkohësit e Fishtës thonë se përshkrimet estetike e madheshtore në veprën “Lahuta e Malcis” përkonin me bukurinë e madhësinë e tij si person fizik. Bashkëkohësit dhe njohësit e tij, e përshkruajnë me ngjyra të veçanta personalitetin fizik të Fishtës.

I.6. Struktura e hulumtimit

Ky studim është strukturuar në katër ndarje ose kapituj kryesorë, përveç abstraktit, përfundimeve dhe bibliografisë së përdorur për të realizuar studimin.

Në kapitullin e parë trajtohet një hyrje e përgjithshme e çështjes në studim, përmes sfondit të hulumtimit, qëllimit, hipotezës, metodologjisë, rëndësisë dhe strukturës.

Në kapitullin e dytë, do të njihemi më në gjerësi me jetën dhe veprën e Fishtës, me mendimin estetik shqiptar në përgjithësi dhe atë të Fishtës në veçanti. Së fundi do të krahasojmë mendimin estetik të Fishtës me disa prej autorëve të tjerë.

Kapitulli i tretë është ai i cili i dedikohet vlerave estetike të “Shinime estetike” dhe veprës madhore “Lahuta e Malcisë” të Fishtës.

Në fund kemi përfundimet dhe bibliografinë e përdorur për realizimin e hulumtimit.

KAPITULLI II. FISHTA, VEPRIMTARIA DHE SHKRIMI ESTETIK I FISHTËS

II.1. JETA DHE VEPRJA

II.1.1. Jeta

Gjergj Fishta, lindi në fshatin e vogël Fishtë të Zadrimës më 23 tetor 1871. Jetën e filloi si barë. Por shumë shpejt, kur ishte 6-vjeçar zgjuarsia e tij i bie në sy famulltarit të fshatit, i cili e dërgon Fishtën në Seminarin Françeskan të Shkodrës.¹ Më 1880, kur hapet seminari në Troshan, ai vijon në këtë shkollë. Këtu ai shfaq trillin poetik. Më 1886 dërgohet për studime në Bosnjë. Vitin e parë e kaloi në Guçjagorë afër Travranikut. Mësimet filozofike i mori në kuvendin e Sutidkës, ndërsa ato teologjike në kuvendin e Livnos. Të kësaj kohe janë edhe “Ushtrimet e para poetike”. Më 1893 i kreu studimet shkëlqyeshëm.

I formuar në periudhën e Rilindjes sonë kombëtare, poeti ynë Gjergj Fishta është një nga vazhduesit më autentikë dhe të drejtpërdrejtë të saj, shprehës i idealeve atdhetare dhe demokratike në kushtet e reja që u krijuan në shekullin e njëzetë. Mënyrat e pasqyrimin të jetës, në krijimtarinë e tij, janë vazhdim i natyrshëm i teknikës letrare të Rilindjes, ku mbizotëron romantizmi, realizmi dhe klasicizmi. Deri më 1899 Fishta shkruan me alfabetin shqip të françeskanëve. Në janar të atj vitit ai bëhet bashkthemelues dhe pjestar aktiv i shoqërisë “Bashkimi”, të cilën e drejtoi poeti atdhetar Preng Doçi. Me alfabetin e kësaj shoqërie u botuan edhe krijimet e Fishtës të kësaj periudhe. Më 1902 emërohet drejtor i shkollës françeskane në Shkodër gjer atëherë e drejtuar nga klerikë të huaj. Menjëherë ai fut gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në këtë shkollë. Arrin të botojë këngët e para të “Lahutës së Malësisë”, kryevepër e poezisë epike shqiptare, më 1904. Më 1907 boton përmbledhjen satirike “Anzat e Parnasit”, më 1909 përmbledhjen lirike “Pika voëset” më 1913 “Mrizi i Zanave”.²

¹ Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992, Fq, 2.

² Flori Bruqi, “Gjergj Fishta: Jeta dhe vepra” (1871-1940). Fq, 3.

Shpejt Fishta u afirmua si poet dhe si atdhetar. Më 1908 ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit si përfaqësues i shoqërisë “Bashkimi”. U zgjodh Kryetar i Kongresit dhe drejtoi punën e Komisionit të Alfabetit.³

Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë ai e kishte pritur me entuziazëm të veçantë, por Luftën Ballkanike dhe Konferencën e Ambasadorëve me një brengë të madhe. Shkodra, qyteti i tij, të cilin kërkonte ta aneksonte Mali i Zi, ishte në duart e fuqive ndërkombëtare. Brenga dhe entuziazmi duken në poezitë, por edhe në shkrimet publicistike që boton në revistën “Hylli i dritës”, revistë letrare-kulturore, të cilën e themeloi në tetor 1913 dhe u bë drejtor i saj. Nën pushtimin austriak boton gazetën “Posta e Shypnisë” (1916-1917), më 1916 themelon, bashkë me Luigj Gurakuqin, Komisinë letrare që kishte për qëllim krijimin e gjuhës letrare kombëtare.

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore përkon me pjekurinë e plotë të personalitetit të Fishtës si poet, si intelektual, si politikan atdhetar. Nga fillimi i prillit 1919 dhe gjatë vitit 1920 është sekretar i përgjithshëm i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në dhjetor 1920 zgjidhet deputet i Shkodrës. Në prill 1921, në mbledhjen e parë të parlamentit shqiptar zgjidhet nënkryetar. Si nënkryetar i Parlamentit kreu veprimtari të dënuara politike. Merr pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924.⁴ Përndiqet pas rikthimit të Zogut në Shqipëri. Vitet 1925 e 1926 i kalon në Itali. Ndërkohë, krijon, boton e riboton pareshtur. Të kësaj kohe janë edhe pjesa më e madhe e dramave, dramave lirike, tragjedive etj. Pas kthimit në Shqipëri nis etapa e fundit e krijimtarisë së Fishtës. Kësaj etape i vë vulën përfundimi e botimi i plotë i “Lahutës së Malësisë”, (1937).

Për veprimtarinë poetike, arsimore, atdhetare e fetare Gjergj Fishta mori nderime të ndryshme. Më 1931 Greqia i jep dekoratën “Foenix”. Më 1939 Italia e bën anëtar të Akademisë së saj. Vdiq në Shkodër më 30 dhjetor 1940.⁵

³ Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992. Fq, 3

⁴ Po aty

⁵ Flori Bruqi, “Gjergj Fishta: Jeta dhe vepra” (1871-1940). Fq, 4.

II.1.2. Vepra

Poezinë e parë Fishta e botoi në “Albania”, më 1899, me pseudonimin “E popullit”. Gjatë veprimtarisë së dendur botuese, e cila, përveçse në librat u publikua edhe në 15 gazeta e revista të kohës brenda edhe jashtë vendit, veprimtaria e tij përfshin 40 vite të jetës, ai përdori 24 pseudonime.

Si krijues Fishta, në radhë të parë ishte poet. Përkushtimin më të madh e pati ndaj epikës. “Lahutës së Malësisë”, veprës së jetës, ai i kushtoi 40 vjet punë. Ndërsa vepra tjetër epike “Moisi Golemi dhe Deli Cena” u botua jo plotësisht në shtypin periodik. Tonet e madhërishme heroike, burimësia e papërsëritshme e përfytyrimeve, shqiptarësia në dhënien e mjediseve, heronjve, rrethanave që kanë bërë që Fishta, si epik të quhej “Homer i Shqipërisë”.⁶ Ndërthurjet e ndryshme të mitologjisë me realitetin, ashpërsia e stilit, mendimi i fuqishëm filozofik, dramaciteti i veprës kanë bërë që Fishta të krahasohet në këtë lëmë me Gëten e Danten.

Kryevepër e lirikës së Fishtës konsiderohet pothuaj njëzëri nga njohësit e tij “Mrizi i zanave”. Ai e ndante lirikën e tij në dy lloje: atdhetaret dhe të përsipirtshmet ose ato të jehonës së shpirtit. Nëse e gjithë krijimtaria e Gjergj Fishtës është quajtur përmendore e gjallë e gjuhës shqipe, poezia e tij “Gjuha shqype” mund të quhet lirika më e bukur që i është kushtuar asaj në krejt poezinë tonë.⁷ Krahasimet e njëpasnjëshme, me thelb metaforik sublim, që shkallëzohen drejt ngjitjes e bëjnë atë krijim himn të përkryer.

Nëse sublimiteti i poezisë së mësipërme realizohet nëpërmjet shprehjeve delikate të brishta e flladitëse, ky tipar në poezinë “28 Nanduer 1913”, “Nji gjamë desprimit”, “Syrgite mortui”, “Emancipacioni i kombit shqiptar”, etj; realizohet përmes vrullit të papërmbajtur, përmes ashpërsisë ngjethëse, përmes thirrjeve dhe kushtimeve luftarake. Poezia “Nji gjamë desprimit” është një gjëmë e një klithmë që akuzon agresionin e Malit të Zi të 16 prillit 1914 ndaj Shkodrës dhe viseve tona veriore. Poezia “Surgite mortui” që fajëson Evropën për të gjithë tragjeditë që po

⁶ Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992. Fq, 4.

⁷ Po aty

i ndodhnin Shqipërisë, e cila s'ka marrë ende frymë nga varfëria pesëshekullore turke, ishte shembull i ashpërsisë së skajshme të stilit të Fishtës ku nuk kursehen përbuzjet, sharjet neveritëse, sarkazma, grotesku, ku u bëhet apel luftarak të gjallëve dhe të vdekurve, varreve dhe djepave.

Në lirika filozofike ai trajton çështje të përgjithshme të jetës e të botës. Ndër më të realizuarat janë “Burrnia”, “Kataklizmi i rruzullimit”, “Një lule vjeshtet”, “Gurrave të Jordanit”, etj. Në poezinë “Burrnia” me një plastikë të përsosur, me një ndërtim të saktë klasik, ndeshen jeta dhe vdekja. Epërsia absolute është në anën e vdekjes, e cila zotëron çdo mjet për ta asgjësuar bukurinë fizike të natyrës dhe të njeriut. Në të kundërtën lirika “Katalikizmi i rruzullimit”, ndonëse ka thelb filozofik, fillesën dhe misionin e ka të natyrës etike, morale. Në emër të së mirës së përdhosur, të së bukurës së shkelur, ai nxit gjithë forcat kaotike, me qëllim që të rivendosë harmoninë mes përbërësve të rruzullit dhe, njëkohësisht në harmoni gjithë rruzullin në Gjithësi.⁸ Në poezinë “Një lule vjeshtet”, me njëmbëdhjetërokëshja të bardhë, poeti ankohet për vdekjen, ngrihet në mbrojtje të idealit të së bukurës, së mirës, së dobishmes. Në odën “Gurrave të Jordanit” në strofa safike ai e përjeton me dhembje të kaluarën që vete e nuk kthehet më, por mbresën, ia ka lënë të pashlyeshme njerëzimit, si vetë rrjedha e ujit që, ndonëse është e përjetshme, sipas dukjes, në të vërtetë rinohet, ndërron paprerë.

Ndër lirikat e buta shquhen “Mbi vorr t’Anton Xanonit” që i afrohet lirikës së llojit intim të shoqërisë e miqësisë për nga fryma e qortimit, e lavdërimit, e mirëkuptimit mes heroit lirik dhe bashkëbiseduesit. Lirikë e mallit universal, për atdheun, nënën, mjediset intime, vatrën familjare, fëmijërinë e rininë është “I dëbuemi”.

Më 1907 Fishta botoi pa emër përmbledhjen e parë satirike “Anzat e Parnasit” e cila u ribotua më 1928 dhe 1942, e pasuruar. Studiuesit hamendësonin nëse Fishta është më i madh si epik, lirik, ose si satirist. Sidoqoftë ai mbetet satiriku më i madh i letërsisë sonë.

Satira e tij u tregua e pamëshirshme ndaj veseve të kohës. Pa kompromis, ai goditi dukuritë e shëmtuara negative dhe mbartësit e tyre, cilëtdo që qenë ata. Këto vese e dukuri ai nuk i luftonte vetëm brenda individit, por në rrafshin e gjithë shoqërisë kombëtare. Ai nuk fal askënd që të abuzojë me postin që mban dhe të zhatë financën kombëtare, të marrë ryshfete, të bëjë veprime

⁸ Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992. Fq, 7.

prej kopuku e dallkauku, të trajtojë Atdheun si çiflikun e tij, si tapet për karrigen e tij. Në radhë të parë ajo është satirë kundër tradhtarëve, atdhemohuesëve, parazitëve të kombit. Në radhë të dytë është satirë kundër elitës zyrtare dhe veseve klasore të saj.

Këtu Fishta na shfaqet si realist i fuqishëm. Vepra artistike më e përkryer artistikisht e Fishtës mbahet “Palokë Cuca”, (1912), bashkë me “Gomarin e Babatasit” (1913) që e botoi me pseudonimin Gegë Toska, janë dy kryeveprat e satirës sonë. “Palok Cuca” është poema e heroit komik. Në thelb, Fishta mbron me këtë vepër shkollën kombëtare. Ai stigmatizon e neverit atë kategori të caktuar njerëzish, që nëpërmjet klerit italian u italianizuan në atë masë, sa që ndihen inferiorë ndaj kulturës dhe gjuhës italiane, aq sa ta quajnë poshtëruese gjuhën amtare.

Nga njësia e familjes Fishta zgjeron rrethin e objektit të satirës së tij në njësinë e shoqërisë, duke e shndërruar veprën në tablo të të gjithë shoqërisë. Për të tallur, përqeshur e goditur Fishta gjen mjetet shprehëse më të përshtatshme. Këtë e realizon përmes fabulës së shtruar në trajtën e tregimit poetik. Një ngjarje të caktuar ai e shtjellon me hollësi, e shqyrton nga të gjitha këndet, duke zberthyer të gjitha mangësitë, shëmtitë, të këqijat që burojnë prej saj dhe infektojnë, sëmurin atmosferën shoqërore e kombëtare. Konkretësia e mjedisëve përmes detajizimeve, gjer në hollësitë më intime e më të turpshme, shndërrohet në qëllim artistik në vetvehte.

Përgjithsimet artistike të fuqishme realizohen me një gjuhë të gjallë, plot kolorit. Përmes një qesëndie që gërryen ngadalë e qetë, në mënyrë të shkallëzuar ai vë pranë në të njëjtin tekst mjedisin konservator, primitiv, arkaik, me atë pseudomodern, pseudoqytetërues të kohës, duke zbuluar anët e shëmtuara të tyre.⁹ Ngjyrimet më popullore satirike, formulat më të spikatura vihen pranë krahasimeve e metaforave nofka, pranë situatave krahasuese e metaforike fyese. Fjalët e shprehjet e huaja, krahas fjalëve shqipe, si kudo në satirën e tij, krijojnë një atmosferë gjuhësore satirike të veçantë. Sidomos kontrastet mes barbarizmave orientale e atyre oksidentale. Ai vëren se si shartohen në një pemë pa rrënjë të kategorisë mediokre të pseudoelitës, aziatizmi me oksidentalizmin e rrejshëm: te folurit e personazheve është edhe mjeti më demaskues i kategorive

⁹ Aurel Plasari, Fishta meditant, parathënie në librin Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli I Dritës & Shtëpia e librit, Tiranë, 1999, fq. 27.

njerëzore që ata përfaqësojnë. Kritika është shprehur me të drejtë se këtu, më shumë se kudo gjetkë, realisti e ka tejkaluar romantikun e klasicistin, satirikun, epikun e lirikun.¹⁰

“Gomari i Babatasit”, u botua në situatë që përkonte me beteja të ashpra politike rreth formës që do të merrte organizimi i ardhshëm shtetëror. Kritika fishtjane me ashpërsinë e saj, që nuk fal askënd, lëshoi mbi kokat e deputetëve, ministrave, gjithfarë zyrtarëve të kohës, talljen, fyerjen, sharjen, nëmën e mallkimit, ironinë, sarkazmën, satirën. Nën moton “Populli i falë ata që e mendojnë por nuk ka për të falë ata që e rrejnë”, ai shpartallon klikën zyrtare, të cilën i vetmi ideal që e bashkonte, ishte marrëveshja e tyre me gjithë mjetet që u kishte dhënë pushteti në dorë, të zhvatnin trupin dhe shpirtin e shtetit të mjerë të sapofromuar dhe ta linin me turpe e shëmtitë jashtë, ndaj syve të botës.¹¹ Poeti Babatasi arkeolog, njeriu i kthyer në gomar e anasjelltas, muzeu formal, injoranca që ka veshur petkun e dijes, së qytetërueses, mjedisi i trashëguar anadollak që belbëzon me gjuhën “oksidantale”, janë mjetet më efikase përmes të cilave Fishta arrin të nxjerrë në pah kontrastet që kthenin në regresin më poshtëruës shoqërinë.

Klika që kërkonte të majmej dhe populli që më kot shpresonte, njeriu që s’dilte dot prej thelbit të vet prej gomari, që ngul këmbë në të vjetrën dhe nuk bën asnjë hap drejt të resë, drejt qytetërimit. Fishta gris pa mëshirë fasadën, që dëshiron të krijojë burokracia shtetërore e sapolindur. Një shtet që po formohet nuk mund të durojë në themelet e veta zhvatës makabër, shtinjakë, hipokritë e servilë. Ai prek ato plagë, që më vonë shoqërisë shqiptare iu bënë pjesë e natyrshme biologjike e qënies, iu bënë sëmundje, pa të cilat nuk e kuptonte dot ekzistencën e vet. Duke e kuptuar që atëherë rrezikun, poeti nuk e ruan aspak gojën, përmes fjalorit dhe vizioneve më lakuriqe, të zhveshura nga çdo paragjykim, bën autopsinë e saktë të shoqërisë që po lindte me vese fizikee shpirtërore, nga më fyeset për një komb që krejt ndryshe e meritonte t’i shpërblehej gjaku dhe mundi mbinjerëzor, që i kishte kushtuar së ardhmes së vet.¹²

Një vend të vëllimshëm në krijimtarinë e Fishtës zë dramaturgjia. Ai shkroi drama, drama lirike (melodrama) dhe tragjedi. Në dramat dhe tragjeditë konflikti është i ndjeshëm. Tonet që i

¹⁰ Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992. Fq. 4.

¹¹ Vehbi Bala, Gjergj Fishta, Jeta dhe vepra, Tiranë, Ombra, GVG, 1998, f. 165

¹² Vehbi Bala, Gjergj Fishta, Jeta dhe vepra, Tiranë, Ombra, GVG, 1998, f. 165

përshkrojnë janë ato heroike. Personazhet dhe karakteret arrihen të skaliten. Në dramat lirike dialogu është më tepër mjet organizues i jashtëm sesa element ndërtues i brendshëm që t'i japë mundësi zhvillimit të veprimeve dhe ashpërsimit të konflikteve. Përsa i përket mjeshtërisë artistike, zotërojnë po ato cilësi që i mishëron edhe krijimtaria poetike. E gjithë dramaturgjia e Fishtës është e shkruar në vargje. Tema e atdhedashurisë është në qendër të pjesës më të madhe të veprave: në dramat “Odisea” dhe “Kthimi i Uliksit në Itakë”, në dramat lirike: “Shqyptari i qytetnuem”, “Shqyptarja e qytetnueme”, “Jerina ose Mbretëresha e Lulevet”, e sidomos tragjedinë “Juda e Makab”, e cila çmohet si vepra më e mirë dramaturgjike e Fishtës. Tema biblike, e pastrimit shpirtëror të njeriut në luftë me veset për hir të virtyteve dhe të amshuesmërisë së qenies njerëzore është në qendër të dramave lirike. “Baritë e Betlemit”, “Luigj Gonzaga”. Tema e padrejtësive shoqërore është në qendër të tragjedisë “Hajria” ku mbizotëron realizmi, fryma demaskuese ndaj klasave të pasura.¹³

Një lëndë prej qindra faqesh përmban proza e Fishtës. Është një prozë e frymëzuar, ku lirizmi krejt natyrshëm ndërthuret me humorin, satira me groteskun. Shtresat e fjalorit janë më të larmishmet. Bashkëjetojnë fjalët, shprehjet, ndërtimet sintaksore krahinore me arkaizmat, barbarizmat, zhargonet, me fjalët e shprehjet e latinishtes, të gjuhëve moderne, perifrazimet, citimet, etj. E pasur në llojet e lëvrimit është publicistika. Për patetikën e fuqishme, argumentin, kritikën shëndoshëse si dhe stigmatizuese dallohen shkrimet me temë shoqërore.

Në shënjestër ai vë dembelizmin, përtacinë, indiferencën e shtetasve të shtetit të ri shqiptar, por edhe lakminë ndaj kolltuqeve, grykësinë ndaj privilegjeve, prirjen regressive ndaj aziatizmit si dhe imitimin banal ndaj perëndimores.

Ai bënte thirrje që në krye të shtetit të vinë njerëz të kulturuar, atdhetarë, vizionarë largpamës të shtetit e të kombit. Fishta është edhe polemist i fuqishëm, ai polemizon me pena të shtypit vendës si dhe me ato të letrave të huaja.¹⁴

Merr në mbrojtje kulturën, dinjitetin, pastërtinë shpirtërore të kombit. Në polemikat nuk mungon kurrë argumenti bindës autentik, si dhe shoqërimi i tyre me argumente nga filozofitë e ndryshme,

¹³ Vehbi Bala, Gjergj Fishta, Jeta dhe vepra, Tiranë, Ombra, GVG, 1998, f. 165

¹⁴ Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992. Fq, 6.

shkencat shoqërore e natyrore, por edhe vërshimet patetike ku shpotit, tall e dermon pa mëshirë kundërshtarin. Të njohura janë dhe ligjëratat e Fishtës, ku mbizotëron fryma solemne dhe argumentuese.

II.2. SHKRIMET ESTETIKE TË FISHTËS

Fishta ka shkruar një trajtesë të shkurtër si traktakt estetik, Shenime estetike: Mbi natyrë t'Artit (1933), të botuara në Hyllin e Dritës.¹⁵ Ka edhe disa shkrime të tjera të Fishtës, qoftë të diskursit letrar apo të atij publicistik, e në të cilin ai trajton çështje të estetikës e të kritikës letrare. Në shkrimet e tij do të veçoja:

- Pikësime estetike mbi zeje të fjalës¹⁶;
- A janë t'zot Shqyptarët me u mbajtë shtet m'vedi?¹⁷;
- Nji atentat shurdhë¹⁸;
- Parathanie në kanunin e Lekë Dukagjinit¹⁹;
- Vierrshat heroike shqyptare²⁰;
- Federata “Vatra” e muzika²¹;
- Për një fjalë të pavend të Z. Mehdi Frashërit²²;

¹⁵ Hylli i Dritës, 1933, nr. 1, fq. 8 - 12, nr. 2, fq. 67 - 75.

¹⁶ Hylli i Dritës, 1932, nr. 7 - 8, fq. 395 - 406.

¹⁷ Hylli i Dritës, 1913, nr. 3.

¹⁸ Hylli i Dritës, 1930, nr. 12, fq. 641.

¹⁹ Hylli i Dritës, 1933, nr. 4, fq. 153.

²⁰ Hylli i Dritës, 1935, nr. 4, fq. 142.

²¹ Hylli i Dritës, 1923, nr. 3, fq. 138.

²² Hylli i Dritës, 1924, nr. 1, fq. 1.

– Hijeve të pernasit²³.

Çështje të estetikës dhe të kritikës letrare hasim edhe në letrat private të Fishtës me At Pal Dodajn, me albanologun Norbert Jokël, etj. Mirëpo, në të gjitha këto raste Fishta ka trajtuar vetëm shkarazi çështjet estetike, derisa në shkrimin Shinime estetike, sado i papërfunduar, ai mëton të shkruaj një traktat original estetik, në të cilin do t'i paraqet konceptet e tij estetike. Themi ai mëton, sepse jo vetëm që shkrimi nuk është i përfunduar, por edhe si i tillë trajton vetëm disa aspekte të estetikës dhe jo gjerësisht fushën e estetikës. Kjo trajtesë e Fishtës ka pasur gjithnjë vlerësimin pozitiv të studiuesve. Sado Ibrahim Rugova as këtë trajtesë nuk e ka identifikuar si të Fishtës, për më tepër ai dyshon mos është i Dr. Kolë Prelës²⁴, e për këtë “mosidentifikim” të shkrimit të Fishtës, Aurel Plasari shprehë habinë me I. Rugovën²⁵, ai e vlerëson shumë lartë trajtesën:

“Njëri ndër punimet më të mira të kësaj natyre te Hylli i Dritës, kryesisht për konceptin tradicional të estetikës, të estetikës klasiciste. Po ashtu shkruan mirë dhe me terminologji të formuar për kohën.”²⁶

Aurel Plasari e shtyn më tutje këtë vlerësim të I. Rugovës:

“Realizimin më të rëndësishëm në këtë fushë, jo vetëm për këtë periudhë por për krejt mendimin teorik-estetik të Fishtës dhe, ndoshta, edhe për traditën e mendimit estetik shqiptar e përbën Shinime estetike: Mbi natyrë t’artit (1933).”²⁷

²³ Hylli i Dritës, 1932, nr. 12, fq. 626.

²⁴ Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 351.

²⁵ Aurel Plasari, Fishta meditants, në Fishta Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999, fq. 18.

²⁶ Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 349.

²⁷ Aurel Plasari, Fishta meditants, në Fishta Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999, fq. 17.

II.3. KONCEPTET ESTETIKE TË FISHTËS

Shkrimi estetik i Fishtës në përgjithësi dhe Shinime estetike, në veçanti, paraqesin pikëpamje të ndryshme të autorit për çështje të estetikës dhe të kritikës letrare. Edhe pse Shinime estetike duket se është konceptuar si një sistem unik mendimi për artin dhe natyrën e tij, shkrimi që sot kemi në dorë nuk është i tillë. Së pari shkrimi nuk është i përfunduar, së dyti në shkrim trajtohen disa çështje të estetikës, por jo estetika si një sistem dijes. Kështu kishte ndodhur më herët edhe me De Radën, sado ai kishte botuar një libër me titullin pretencioz “Parime të estetikës”, megjithatë, mendimi i tij është pikëpamje individuale për disa çështje të estetikës e jo sistem unik dijeje për estetikën. Shkrimi estetik i Fishtës paraqet mendime, koncepte e pikëpamje të Fishtës, vetjake ose tradicionale, për çështje të veçanta estetike, por ai nuk arriti kurrë të krijojë një sistem unik dijes për natyrën e artit, si mëtohet në pjesën e dytë të titullit të shkrimit. Por, edhe si të tilla, këto koncepte të Fishtës paraqesin interes, jo vetëm për historinë e mendimit estetik shqiptar, por edhe për dijen e sotme estetike shqiptare.

II.3.1. E bukura dhe e mira në natyrë ²⁸

Sendet në natyrë janë të bukura, ato janë të bukura sepse janë të pëlqyeshme (“shka pelqen, asht gjithmonë edhe të bukur” ²⁹); ato janë të trajtuara prej Shkasit të Parë, po duke qenë se janë në natyrë, e natyra është e kufizuar, edhe këto sende janë të kufizuara dhe nuk bartin në vete shkëlqimin e prototipit të tyre, Shkasit të Parë (“perfekcioni i pamasë gjindet vetun në Zotin” ³⁰);

²⁸ Fishta, Piksime estetike mbi artin e fjalës, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003, fq. 130-156.

²⁹ Gjergj Fishta, Shinime estetike ..., I, fq. 133.

³⁰ Gjergj Fishta, Shinime estetike..., II, fq. 135.

pra, bukuria e sendeve në natyrë është e kufizuar (“sendet të gjitha mund të jenë fort ma të mira e ma të bukura se janë në natyrë”³¹).

Ky është koncepti i Fishtës për të bukurën në natyrë, i cili është i afërt me konceptin estetik mesjetar krishter. Ndërsa marrëdhënia midis të bukurës dhe të mirës është koncept klasikist:

Parimi i Shkasis të Parë është trajtuar thelbësisht nga Plotini (204 - 270). Sipas tij Njëshi (shkasi i parë) ka krijuar natyrën përmes vizionit.

Njëshi dhe vizioni i tij janë përkryeshmëria, burim dhe shëmbëllim i artit.³² Edhe pse Plotini askund nuk e përmend krishterimin, koncepti i tij për Njëshin dhe kërkimi i shpëtimit në bashkimin mistik të njeriut me Njëshin është shumë i afërt me krishterimin.³³

“Ura lidhëse në mes të filozofisë së Shën Augustinit dhe filozofisë klasike do të jenë shkrimet e Plotinit.”³⁴

Ndërsa më vonë, vetë Shën Augustini (354-430) ka thënë se Plotinit duhet t’i ndryshosh “vetëm disa fjalë” që ai të bëhet i krishterë.³⁵ Dihet mirë se njëra prej këtyre fjalëve të ndryshuara është Njëshi i shndërruar në Zot. Koncepti i Fishtës për Shkasin e Parë vjen nga ky koncept i ndryshuar i Shën Augustinit. Po ashtu edhe koncepti i tij për bukurinë e kufizuar të sendeve në natyrë dhe bukurinë e pamasë të prototipave të Shkasis të Parë vjen prej Shën Augustinit, sikurse edhe vetë koncepti për intuitën, të cilën Fishta e quan Gen, vjen po prej Shën Augustinit, i cili thotë (në parafrazim):

Krejt çka ka krijuar Zoti e ka krijuar në shëmbëllim të vetin. Zoti është i bukur po edhe krijesat e tij janë të bukura. Por sendet nuk mund të jenë të bukura sa vetë Zoti. Bukuria e tyre është e

³¹ Gjergj Fishta, *Shinime estetike...*, II, fq. 135.

³² Gilbert-Kun, *Istorijs estetike, Kultura*, fq. 101-102.

³³ Shih për afërsinë e neoplatonistëve me krishterimin në librin *Rrëfimet të Shën Augustinit*, Plejad, Tiranë, 2006, fq. 161-174.

³⁴ Samuel E. Stumpf, *Filozofia-historia dhe problemet*, Botimet Toena, Tiranë, fq. 120.

³⁵ Samuel E. Stumpf, *Filozofia-historia dhe problemet*, fq. 120.

kufizuar. Vepra e Zotit nuk është pasqyrë e tij, ajo është vetëm hije e tij, pasi që ajo ngushtohet nga materia e vrazhdë.³⁶

Ky koncept i Shën Augustinit është tërësisht i krahasueshëm dhe i njëjtësuar me konceptin e mësipërm të Fishtës. Sipas këtij koncepti dallohen tri përmasa të së bukurës: e bukura absolute, ajo e Shkasit të Parë, të cilën njeriu mund ta paragjykojë si një vizion, por nuk mund ta shohë; e bukura në natyrën që është hije e së bukurës absolute (nuk është reflektim i saj) dhe kjo e bukur është e shkallës së ulët, sepse e ngushton materia; e bukura në art, që është prodhim i gjenit të njeriut dhe është më e vogël se e bukura absolute dhe më e madhe se e bukura në natyrë.

II.3.2. E Bukura dhe e Pëlqyeshmja

Fishta të bukurit e nxjerr prej të pëlqyeshmit: “shka pelqen, asht gjithmonë edhe të bukur”³⁷. Ky është koncept i Horacit (65-8 p. K.), i shprehur përmes formulës së njohur “dulce et utile”.

Pëlqimin e plotë do ta ketë ai që të dobishmen e gërsheton me të këndshmen, duke argëtuar lexuesin po edhe duke e këshilluar.³⁸

Arti krijon kënaqësi dhe i shërben një qëllimi moral. Shën Augustini thotë se ajo që na pëlqen në tokë e në qiell është e bukur.³⁹ Ky rregull i Horacit është formula që rregullon marrëdhënien midis artit dhe utilitarizmit edhe në estetikën mesjetare.

II.3.3. E Bukura që ngjallitë artin

Duke rezymuar mendimin e Fishtës për lindjen e artit, del se:

³⁶ Gilbert-Kun, Istorija estetike, Kultura, fq. 127.

³⁷ Shën Augustini, “Rrëfimet”. Fq. 293.

³⁸ Gjergj Fishta, Shinime estetike..., I, fq. 133.

³⁹ Horaci, Arti Poetik, përkthyer prej Dr. Engjëll Sedaj, Buzuku, Prishtinë, fq. 55, vargjet 343-344.

Kjo bukuri e sendeve nuk është bukuria prej të cilës ngjallitë arti; sendet në natyrë janë një jehonë e të bukurës perfekte, e që është e bukura që rrjedh nga prototipat e sendeve në vetë Zotin. Njeriu nuk mund ta shohë të bukurën perfekte (sepse të verbon sikur rrezja e diellit) por nuk kënaqet edhe me bukurinë e sendeve në natyrë, sepse ajo bukuri është e kufizuar e sendet mund të jenë edhe më të bukura.

Prandaj njeriu krijon në mendjen e vet përfitim për sendet; ky përfitim quhet Ide gjnjale; e Bukura rrjedh prej përfimit apo prej Idesë gjnjale, dhe është e bukur më e madhe se ajo e sendeve në natyrë dhe më e vogël se të bukurit e sendeve prototipa që kanë ekzistuar vetëm në përfitim e Zotit.⁴⁰

Këto koncepte të Fishtës për të bukurit që krijon artin dhe për mënyrën se si krijohet të bukurit e artit janë një gërshetim i koncepteve të Shën Augustinit dhe të Hegelit. Koncepti i Hegelit (1710-1831) për të bukurën e kufizuar në natyrë, për të bukurit perfekt të materien e perëndishme janë të afërta me konceptet e Shën Augustinit. Fishta merr prej Hegelit Idenë gjnjale, që te Hegeli është Gjeniu krijues: Gjenialiteti është pasion natyror i lindur (...) që botës imagjinate dhe emocionale t'i japë formë.⁴¹

Duke kaluar nëpër trurin e gjenit (artistit), proza e realitetit dhe vrazhdësia e natyrës së pagdhendur fitojnë elasticitetin dhe harmoninë e shpirtit.⁴²

II.3.4. Arti nuk është imitim

Duke qenë se arti është prodhim i përfimit të artistit (bukuria rrjedh, jo prej sendeve në natyrë, por prej një ideje të përfueme në intuitën në mendje të artistit mbi sendin⁴³), e i cili përfitim nxitet nga bukuria e sendeve në natyrë, por nuk kënaqet me të sepse frymëzohet prej të bukurës prototipe

⁴⁰ Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 116.

⁴¹ Fishta, Shinime estetike....

⁴² Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 364.

⁴³ Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 361-362.

(përftimi i Zotit), atëherë Fishta thotë se arti nuk është imitim i natyrës dhe as i traditës. Me këtë koncept Fishta bie në kundërshtim të plotë me teorinë klasiciste, sipas së cilës arti është mimezis, ashtu siç e kishte përkufizuar Aristoteli në Antikë dhe Boalo në Mesjetë. Platoni e kishte përkufizuar artin si frymëzim nga zotat, si një frymëzim i marrë, sepse poetët këndojnë për gjërat që nuk i kuptojnë, ndërsa Ciceroni i pari e kishte përdorë nocionin fantazi, për të mbërritur deri te Hegeli dhe Gjenui krijues i tij, të cilin koncept e absorbon Fishta. Duke qenë se arti është prodhim i mendjes së njeriut, ai është botë më vete, sipas Fishtës. Me postulatit se arti është prodhim i mendjes së njeriut Fishta njëjtësohet me konceptet romantike, sipas të cilave arti është prodhim subjektiv i mendjes së njeriut përmes Gjenuit krijues.

II.3.5. Vepra artistike-botë më vete

Duke ndarë të bukurit nga ajo e sendeve në natyrë dhe nga të bukurit prototip (Njëshi te Plotini, Zoti te Shën Augustini dhe Materja e perëndishme te Hegeli), Fishta krijoi mundësinë për teorinë e veprës artistike si botë më vete. Ky koncept i Fishtës për artin si botë më vete ka një origjinalitet të kufizuar dhe paraqet interes të madh për mendimin estetik shqiptar, qoftë për shkak të origjinalitetit apo për idenë moderne që përmban. Vepra artistike është botë më vete, më e lartë se ajo e sendeve në natyrë dhe më e ulët se ajo e krijimit prototip. Me këtë përfundim Fishta pranonte rolin dhe mundësinë e artit për ta ndryshuar natyrën. Ky koncept është shumë i vjetër dhe fillon me Platonin (428-427 p. K.). Platoni thotë se poezia e ndryshon, më drejt e shtrembëron realitetin, sepse ai imiton vetëm njëërën anë të realitetit, të mirën, dhe nuk imiton anën tjetër, të keqen; po ashtu arti është së paku dy hapa larg realitetit. Duke imituar vetëm njëërën anë të realitetit dhe duke qenë larg realitetit, arti shtrembëron realitetin.⁴⁴

Në kufirin e fundit të Mesjetës, një estet, Filip Sidni, thotë se arti e ndryshon natyrën dhe poeti e ka atë të drejtë dhe atë mundësi për ta ndryshuar natyrën sepse atë mundësi ia ka dhënë Krijuesi i Natyrës, duke e bërë edhe këtë, artistin, krijues.⁴⁵

⁴⁴ Gjergj Fishta, *Shinime estetike...*, V, 144.

⁴⁵ Platoni, *Shteti*, Libri III; shih edhe S. E. Stumpf, *Filozofia-historia dhe problemet*, Botimet Toena, Tiranë, fq.53-54.

Ndërsa Hegeli e përkufizon deri në fund botën më vete të artit:

Për këtë arsye ideali duhet të kërkohet në art e jo në natyrë. Sepse arti është natyra e ringjallur për herë të dytë, natyra e rilindur me zbulimet e gjenit. Duke kaluar nëpër mendjen e poetit, proza e realitetit dhe vrazhdësia e natyrës së pagdhundur fitojnë elasticitetin dhe harmoninë e shpirtit.⁴⁶

Nëpër këto koncepte, Fishta e quan punën e poetit creativo, d.m.th. krijim, prodhim, pra artisti është krijues, sikurse vetë Zoti, vetëm se në përmasa më të vogla. Ndërsa për veprën e artit thotë se është “nji krijesë (creatio)...ajo asht dishka krejt m’vedi (quid unicum), nji individuum permbrenda rruzullimit, por qi nuk asht pjesë e rruzullimit....⁴⁷

II.3.6. Teoria e dy Rruzullimeve

Duke qenë se vepra e artit është botë më vete dhe artisti është krijues që prodhon, dhe që të dy së bashku ekzistojnë përbrenda një rruzullimi po që nuk janë pjesë e tij, atëherë Fishta përfundon me teorinë e dy Rruzullimeve: rruzullimi (bota) reale, natyra, kjo e krijuar prej Zotit, po që nuk është e përkryer dhe rruzullimi (bota) e krijuar nga artisti, që ekziston përbrenda rruzullimit të parë, por nuk është pjesë e tij (VII, 149). Fishta përdallon këto dy botë:

Ky rruzullim ideal, mandej, asht ma i haptë e ma i madhueshem se rruzullimi real; pse kah neper imagjacion mundet me da e me bashkue pjesët e gjymtyrët e do sendeve m’sende tjera, kshtu mrrinë me krijue individuum të ri në rruzullim të vet, per shembull: hipogrifi (kal me fletë) qi në rruzullim të dukshëm nuk ekziston aspak.⁴⁸

Këto koncepte për rruzullimin ideal janë shumë të afërta me ato të Hegelit për të bukurën në art. Por, këtu mund të shohim një dritë të origjinalitetit të Fishtës i cili e ndan prerat botën ideale të artit nga bota reale, edhe pse ajo qenëson brenda saj. Diçka të ngjashme kishte deklaruar Filip Sidni (1554-1586), por ai botën e artit e quante më të mirë se bota e Zotit (bota reale e krijuar prej

⁴⁶ Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 158.

⁴⁷ Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 362.

⁴⁸ Fishta, Shinime estetike..., I, 133.

Zotit). Në të vërtetë, po ta vazhdojmë deri në fund konceptin e Fishtës për dy rruzullimet, edhe te koncepti i Fishtës shkohet në të njëjtin përfundim, sikurse edhe te Sidni, se bota e krijuar prej artistit është më e mirë se bota empirike e krijuar nga vetë zoti. Ky me të vërtetë është një përfundim tepër i guximshëm për një prelat, i cili tërë jetën e tij ia kishte kushtuar edhe çështjes së fesë krishtere.

Mirëpo, pavarësisht nga ndonjë ide origjinale, gjithë konceptet estetike të Fishtës janë të marrë prej filozofëve e estetëve të tjerë, si prej Platonit, Plotinit, po te Fishta kanë mbërritur në formën që u kishte dhënë esteti i parë i madh i krishterë Shën Augustini. Koncepte të tjera estetike Fishta i ka marrë prej Hegelit, që ishte krye esteti mbi të cilin u mbështetën teoricienët e romantizmit.

Në konceptet e Fishtës dallohen qartë koncepte të estetikës klasiciste, koncepte të estetikës krishtere mesjetare, dhe koncepte të estetikës së re dhe romantike.⁴⁹ Por, për herë të parë në mendimin estetik të një autori shqiptar dallohen qartë edhe konceptet origjinale estetike.

Duke i parë kështu konceptet estetike të Fishtës ne besojmë se këto koncepte janë shumë larg nga shqyrtimi i tyre si të pavarura dhe jashtë teorive të tjera tradicionale estetike, si propozon Aurel Plasari⁵⁰ dhe shumë larg të shqyrtimit të tyre si koncepte origjinale estetike, siç propozon Kujtim M. Shala.⁵¹ Bile-bile, në vrapin për të shpallur teori origjinale estetike shqiptare, konkretisht të Fishtës, fakti që sjell Plasari, se si Fishta ia ka dërguar këto koncepte estetike një esteti anglez të specializuar në estetikë në Universitetin e Kembrixhit dhe se ai ia ka kthyer përgjigjen se bëhet fjalë për një teori të re estetike⁵², duket sa qesharak aq edhe vetë përbuzës, edhe pse shkruesi e ka përmendur si fakt lavdërues për Fishtën. Madje, në një letër për Atë Pal Dodaj, dorëshkrim i vitit 1910, Fishta flet për bashkim konceptesh të ndryshme estetike dhe letrare në veprën e vet:

⁴⁹ Fishta, *Shinime estetike...*, VII, 149.

⁵⁰ Edhe studiuesi i letërsisë popullore A. N. Berisha konstaton eklektizmin e koncepteve estetike të Fishtës. Shih: A. N. Berisha, *Pikësime estetike mbi artin e fjalës*, Shpresa, Prishtinë, 2003, fq. 27.

⁵¹ Fishta, *Shinime estetike...*, VII, 148.

⁵² Aurel Plasari, *Fishta meditant, në Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit*, Tiranë, 1999.

“Kshilla qi m’jep, lidhun me formen e stilin qi duhet perdorë në kte pjesë të tretë (të Lahutës së Malcis, plotësim imi, B. K.), asht e drejtë. Me gjith kta, tue shfrytëzue të njajtën formë dhe tue ia bashkue stilin popullor atij klasik, do të perpiqem (...).”⁵³

Fishta këtu flet për bashkim të qëllimshëm të stilit klasicist me atë popullor, e këtë të fundit romantikët e kishin shndërruar në burimin kryesor për letërsinë e tyre.

II.4. KRAHASIME PËRGJITHËSUESE TË FISHTËS ME MENDIME TË TJERA ESTETIKE-KRITIKE

II.4.1. Hyrje e shkurtër për mendimin estetik Shqiptar

Është shumë i luhatshtëm emërtimi “mendimi estetik shqiptar” përpara shekullit XX. Jo vetëm për shkak të shfaqjes së vonshme të mendimit estetik në literaturën shqipe, por më tepër për shkak të mungesës së traktateve estetike të autorëve shqiptarë. Shqyrtimi i kategorive të estetikës ka filluar në kulturën evropiane me filozofët antikë grekë, pikërisht me Platonin e Aristotelin, por si disiplinë më vete është themeluar me filozofin gjerman A. G. Baumgarten (1714-1762), fillimisht në shkrimet Disa gjëra në lidhje me poezinë (1735) e pastaj në veprën kryesore të tij Aesthetica (1750).⁵⁴ Në historinë e literaturës shqipe Pjetër Bogdani i pari ka trajtuar disa çështje të estetikës.⁵⁵ Traktati i parë “i mirëfilltë estetik shqiptar” është Parime të estetikës (1861) i De Radës,⁵⁶ edhe kjo e shkruar në italisht.⁵⁷ Sado shkrimtarë e filozofë shqiptarë kanë trajtuar pas De Radës çështje të ndryshme të estetikës, deri në gjysmën e dytë të shekullit XX nuk janë shkruar traktate origjinale estetike, pavarësisht se në gjysmën e parë të shekullit XX pati disa libra për çështje të ndryshme të teorisë së letërsisë, si Vargnimi në gjuhën shqipe (1906) i Luigj Gurakuqit, Prisi në lamë të

⁵³ Kujtim M. Shala, *Shinimet e Fishtës*, AIKD, Prishtinë, 2002.

⁵⁴ Gilbert-Kun, *Istoriya estetike*, Kultura, Beograd, 1969, fq. 243.

⁵⁵ Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit*, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 112-122.

⁵⁶ Jup Kastrati, *Studime për De Radën*, Gjonlekaj, NY, 2003, fq. 250.

⁵⁷ De Rada, *Vepra 7*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 256.

letraturës (1911) i Justin Rrotës, Fillimet e stilistikës e të letërsisë së përgjithshme (1930) të Aleksandër Xhuvanit e Kostaq Cipos etj.

Parime të estetikës e De Radës ka një rëndësi të veçantë pikërisht se është traktati i parë estetik shqiptar. Por studiuesit e De Radës kanë vënë re gjithnjë se libri nuk mund të përkufizohet saktësisht si traktat estetik, sepse “vepra nuk merret tërësisht me probleme estetike”⁵⁸, ndërsa Engjëll Sedaj e quan “trajtesë filozofike dhe teoriko-letrare”.⁵⁹

Kjo vjen për shkak të faktit se De Rada trajton në këtë libër edhe çështje të pastra filozofie (si: shpirti dhe mendja), çështje të politikës (si: partitë politike e demokracia), por edhe çështje të rëndësishme nga jeta e arbëreshëve (si: këngët popullore arbëreshe, roli i Kolegjit të Shën Adrianit etj.). Në anën tjetër, trajtesa nuk është e plotë në tërësinë e saj, jo vetëm për shkak të disa pjesëve që i mungojnë, por si koncept estetik nuk është i tërësishëm dhe i përfunduar. Rexhep Qosja sado thekson se Parime të estetikës përfaqëson estetikën dhe teorinë e Jeronim De Radës, vëren se:

“... estetika dhe teoria e Parimeve të estetikës nuk e mbulojnë plotësisht, herë- herë as për afërsisht, edhe poetikën e tij praktike: poetikën që mund të nxirret prej veprave të tij poetike në tërësi.”⁶⁰

Kjo do të thotë se ekziston një dallim midis koncepteve teorike dhe estetike mbi të cilat janë krijuar veprat e De Radës dhe atyre të cilat ai i ka shprehur në librin Parime të Estetikës. Ky dyshim, për mendimin tonë i drejtë i R. Qosjes, krijon bazën për të vënë në dyshim edhe origjinalitetin e pikëpamjeve estetike të De Radës: çështjet estetike që ai i trajton në librin e tij, e që sipas Alberto Stratikoit (1863-1926) janë ligjërata të De Radës të mbajtura para studentëve të Kolegjit të Shën Adrianit⁶¹, janë origjinale të tij apo janë eklektike?

Me gjithë këto mangësi të librit studiuesit e çmojnë vlerën e tij:

⁵⁸ Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 250.

⁵⁹ Jeronim De Rada, Vepra 7, fq. 255.

⁶⁰ Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqiptare, Romantizmi II, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 140.

⁶¹ Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, Faik Konica, Prishtinë, 2005, fq. 49-50.

“Sot, ne mund të shtojmë se kjo është më e madhja vepër teorike në kulturën shqipe, deri në kohën e paraqitjes së saj.”⁶²

Në shqyrtimin e pikëpamjeve estetike në literaturën shqipe ky libër i De Radës është i pa anashkalueshëm.

Mbas De Radës është edhe një emër në historinë e mendimit kritik dhe estetik, i cili ka shndritë dhe vazhdon të shndrisë edhe sot letërsinë shqipe me thellësinë e gjykimit kritik: ai është Faik Konica (1875 - 1942). Edhe Faik Konica nuk ka shkruar një traktat estetike e as do të arrijë të krijojë një sistem estetik të vetin, por ka shkruar disa ese në të cilët ka vënë bazat e kritikës (moderne) shqipe dhe ka trajtuar çështje të estetikës. Siç thotë Sabri Hamiti, ai është themeluesi i kritikës shqipe:

“... kritiku i parë i shqipes, jo pse ky i pari shkroi kritika me vlerë për veprat shqipe dhe shfaqti ide për vepra dhe për autorë shqiptarë, që më vonë ose u zhvilluan më tej ose u kritikuan rëndë, po pse është i pari që kritikën letrare e shkroi me një vetëdije letrare, e përkufizoi si zhanër letrar dhe, më në fund, e përkufizoi funksionin e saj në kuadrin e zhvillimit të letërsisë kombëtare.”⁶³

Po ashtu, Sabri Hamiti e quan Konicën si eseisti i parë shqiptar.⁶⁴ Ndërsa Aurel Plasari i atribuon Konicës edhe një shteg të ri:

“Konica do të jetë (historikisht) edhe i pari mendimtar shqiptar që përhapë ide estetike bashkëkohore në kulturë përgjithësisht.”⁶⁵

⁶² Sabri Hamiti, Studime letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003, fq. 85.

⁶³ Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 287.

⁶⁴ Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 299.

⁶⁵ Aurel Plasari, Fishta meditans, parathënie në librin Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli I Dritës & Shtëpia e librit, Tiranë, 1999, fq. 10.

Ky konstatim i Plasarit duhet të sqarohet, sepse është mendimi estetik i Bogdanit, sado i pjesshëm, megjithatë është nismëtar, është Bogdani autori i parë historik i mendimit estetik shqiptar, ndërsa Konica përhapës i “ideve estetike bashkëkohore”.

Në këtë kapitull ne do të shqyrtojmë pikëpamjet estetike të Gjergj Fishtës, duke i krahasuar ato me mendimin estetik të traditës, e në radhë të parë me mendimin estetik të Pjetër Bogdanit e të De Radës, si dhe me mendimin kritik të Faik Konicës, bashkëkohës i Fishtës.

II.4.2. Krahasime përgjithësuese të Fishtës me Pjetër Bogdanin

Duke shqyrtuar veprën Çeta e Profetëve (1675-1685) të Pjetër Bogdanit (rreth 1630-1689), një vepër universale, Ibrahim Rugova ka përmbledhur disa mendime estetike të Bogdanit të dhëna në kontekste të ndryshme dhe këtyre koncepteve ua ka kushtuar një vend të rëndësishëm në veprën e tij Vepra e Bogdanit (1982). Rugova e kornizon mendimin estetik të Bogdanit në filozofinë dhe estetikën e Mesjetës:

“E bukura realizohet në planin ontologjik si esencë, si qenie e qenies më të lartë Zotit dhe si inkarnim i tij në qeniet dhe fenomenet e tjera në natyrë.”⁶⁶

Ky koncept i të bukurit lidhet me etikën, sepse sipas konceptit mesjetar të krishter nuk ka të bukur pa etikë.

Këto koncepte të Bogdanit, sado të pasistemuara e anësore, i ka njohur Fishta. Konceptet e Fishtës përkojnë me këto të Bogdanit, jo vetëm për shkak të kontaktit me veprën e Bogdanit, por nga shkak se konceptet e të dyve kanë një burim: filozofinë dhe estetikën e Mesjetës, me epërsinë e Fishtës se ai i ka zhvilluar konceptet e tij edhe me gërshetimin e koncepteve estetike të Hegelit.

⁶⁶ Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 113.

II.4.3. Krahasime përgjithësuese të Fishtës me Jeronim De Radën

Krahasimi i parë, i thellë, i koncepteve estetike të Fishtës në traditën letrare shqiptare duhet të bëhet detyrueshëm me konceptet estetike të De Radës, më së pakut për dy arsye: së pari De Rada është poeti i parë romantik shqiptar dhe njëri prej dy poetëve më të mëdhenj romantikë, së dyti për shkak se Parimet e estetikës (1861) i De Radës është traktati i parë estetik prej një autori shqiptar, edhe pse i shkruar në italisht.

Siç është vënë në dukje edhe nga studiuesit e tjerë, ka një dallim midis koncepteve teorike dhe estetike mbi të cilat janë krijuar veprat e De Radës dhe atyre të cilat ai i ka shprehur në librin Parime të Estetikës.⁶⁷

Në shumë koncepte të tija të shtruara në Parime të Estetikës De Rada flet si një klasikist. Ne këtu nuk duam t'i klasifikojmë këto koncepte, por vetëm po i përmendim për krahasime të mëtejme. Kështu, për të Bukurën ai thotë se “gjendet kudo në botë, ai është i pakufijshëm”⁶⁸, e që është koncept klasikist për të bukurën objektive. Po ashtu, ai e vë në lidhje të dobishmen me të bukurën afërsisht si klasikistët: “Pra, e dobishmja dhe të Bukurit janë dy burime të së Mirës njerëzore...”⁶⁹, dhe vë në lidhje të pashkëputshme estetikën dhe etikën, përkatësisht të bukurit me qëllimin moral: “Kudo që është të Bukurit, aty gjithmonë gjendet edhe morali”.⁷⁰

Në anën tjetër, De Rada shqyrton dhe mbarështon në Parime të estetikës shumë koncepte estetike dhe sidomos poetike të romantizmit.

Kështu ai flet për atdheun dhe dashurinë ndaj tij si për një qëllim moral artit, flet për arsimimin e qytetërimin e popujve, për Kolegjin e Shën Adrianit, etj. Në veçanti, kur De Rada flet për këngët

⁶⁷ Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqiptare, Romantizmi II, fq. 140.

⁶⁸ De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 154.

⁶⁹ De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 155.

⁷⁰ De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 159.

popullore shqiptare dhe bukurinë e paanë të tyre⁷¹ dhe për gjuhën popullore ai flet si një romantik i vërtetë, duke e ngritur gjuhën pothuajse në një kategori estetike:

“Duke përkujtuar këngën e vjetër popullore, në të cilën ruhen gjurmat e pavdekshme të jetës sonë vetanake, bindemi se në gjuhën shqipe jeton shpirti ynë”⁷².

Për dallim nga konceptet eklektike të shprehura në Parime të Estetikës, në veprën e tij letrare De Rada u përmbahet besnikërisht teorive dhe rregullave romantike të shkrimit. Letërsia e tij është fund e krye romantike: edhe në rregullat e shkrimit, edhe në frymën e përgjithshme, edhe në tematikën, motivet e në idetë poetike, edhe në figuracion, etj.

Duhet të përmendet edhe fakti se në librin e De Radës ka edhe kundërshti mendimesh. Kështu, ai për të bukurit thotë se është kudo në natyrë (të bukurit objektiv), ndërsa në një vend tjetër thotë se “është lehtë të kuptosh se çdo gjë e bukur është, në të vërtetë, koncept i mendjes”⁷³, (të bukurit subjektiv).

Duke përfunduar për konceptet estetike të De Radës mund të themi se dallimet midis veprës letrare të tij, të shkruar mbi parime e teori romantik, dhe veprës së tij estetike Parime të Estetikës, në njërin anë dhe, gërshetimi i koncepteve të estetikës klasiciste e romantike, në anën tjetër, na bëjnë të besojmë se De Rada nuk pati jo vetëm një sistem të krijuar të mendimit estetik, por ai nuk pati edhe një sistem unik të mendimit estetik. Prandaj, duhet të besojmë se konceptet estetike të De Radës janë gërshetime konceptesh të ndryshme të cilat nuk mund të paraqesin një sistem unik të mendimit estetik, por që mbizotërohen nga koncepte romantike. Edhe Ibrahim Rugova pak a shumë ka këtë përfundim:

“...vepra e De Radës Parime të Estetikës (1861) ku kemi një platformë të interesimeve estetike romantike përgjithësisht.”⁷⁴

⁷¹ De Rada, Vepra 7, Parime të Estetikës, fq. 180-184.

⁷² De Rada, Vepra 7, Parime të Estetikës, fq. 208.

⁷³ De Rada, Vepra 7, Parime të Estetikës, fq. 159.

⁷⁴ Ibrahim Rugova, Kahe dhe Premisa të Kritikës Letrare Shqiptare 1504-1983, fq. 47.

Edhe Sabri Hamiti pak a shumë bën të njëjtin përfundim:

“Parime të estetikës, si vepër teorike e estetike, bashkon në vete, teorinë romantike mbi poezinë, të bazuar kryesisht në përvojën personale poetike dhe në estetikën personale të De Radës dhe etikën e krishterë...”.⁷⁵

Mirëpo, Ibrahim Rugova sugjeron një qasje nga një kënd tjetër ndaj veprës së De Radës:

“Me këtë rast shprehim mendimin tonë se vepra e De Radës, duhet të kuptohet në metodë, e jo të kualifikohet si fragmentare e heterogjene, apo si përmbledhje pikëpamjesh të ndryshme sepse fushat e jetës dhe të filozofisë që i përdorë ai, metodologjikisht, mund të konsiderohen si argumente shkencore për të argumentuar filozofinë e tij të së Bukurës dhe të se Ndershmes.”⁷⁶

Duke krahasuar konceptet estetike të Gjergj Fishtës me ato të De Radës mund të përfundojmë:

- edhe De Rada edhe Fishta kanë shkruar traktate estetike, me qëllim të krijimit të një sistemi të tyre estetik;
- edhe De Rada edhe Fishta nuk kanë një sistem të krijuar të mendimit estetik, por konceptet e tyre ngjajnë në absorbim të disa koncepteve e mendimeve estetike, shpeshherë të ndryshme midis tyre, e nganjëherë ngjajnë edhe në koncepte të kompiluara estetike;
- derisa De Rada nuk ka arritur të krijojë një sistem unik të mendimit estetik, të pakundërshtueshëm në vetvete, Fishta gërsheton ato koncepte estetike që mund të gërshetohen: konceptet e Shën Augustinit e Tomë Akunit me konceptet romantike të Hegelit;
- edhe De Rada edhe Fishta në shqyrtimet e tyre estetike nisen nga kategoria kryesore estetike: të bukurit.
- derisa De Rada kalon katërçipërisht kufijtë e estetikës së tij në veprën e tij letrare, duke shkruar vepra tërësisht romantike, Fishta u përmbahet parimeve të tij estetike dhe rregullave e teorive të shkrimit klasikist, duke gërshetuar edhe në letërsinë e tij parime e

⁷⁵ Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 93.

⁷⁶ Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 52-53.

rregulla klasiciste dhe ato romantike: në format poetike, në metrikë dhe në gjinitë letrare Fishta është klasicist, ndërsa në tematikën, në motivet, në idetë poetike dhe në mesazhet poetike ai është edhe romantik edhe pasromantik;

- edhe në lidhshmërinë e estetikës me shoqërinë e shtetin De Rada ka koncepte më moderne, të ndikuara nga Revolucioni Borgjez Francez, ndërsa Fishta ka koncepte mesjetare për një komb, koncepte teologjike për kombin.⁷⁷

II.4.4. Fishta dhe kritika letrare e Konicës

Me shkrimin e njohur Kohëtore e letrave shqipe⁷⁸, një manifest i kritikës letrare shqipe, shkruar më 1906, Faik Konica (1875-1942) bëhet themeluesi i kritikës moderne letrare shqipe. Studiuesi i tij i parë i tërësishëm, Sabri Hamit, në librin Faik Konica: Jam unë (1991) thotë:

“Faik Konica është quajtur edhe më përpara, kritiku i parë i shqipes, jo pse ky i pari shkroi kritika me vlerë për veprat shqipe dhe shfaqti ide për vepra dhe për autorë shqiptarë, që më vonë ose u zhvilluan më tej ose u kritikuan rëndë, po pse është i pari që kritikën letrare e shkroi me një vetëdije letrare, e përkufizoi si zhanër letrar dhe, më në fund, e përkufizoi funksionin e saj në kuadrin e zhvillimit të letërsisë kombëtare.”⁷⁹

Përfaqja e mendimit dhe e shkrimit kritik të Konicës me atë të Fishtës shkon jo në drejtim të përafritimit, por në drejtim të largimit. Sa më shumë ta përimitosh këtë përfaqje aq më e madhe bëhet largësia midis dy autorëve tanë të mëdhenj, të cilët jetuan në të njëjtën kohë dhe jetuan të njëjtën

⁷⁷ Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 342. Shih shkrimet publicistike të Fishtës: Perlumi i Perkohshmjes (HYLLI I DRITËS, nr. 1, 1913), Shteti e Besimi (Posta e Shqypnisë, nr. 19, 1916), Lajçizmi në Prendim? (HYLLI I DRITËS, nr. 9 dhe 10, 1933), Kisha Katolike ka trajtue kulturen oksidentale (HYLLI I DRITËS, nr. 4, 5, 6, 1923), Arsim apo luftë kundra Katoliqizmit në Shqypni? (HYLLI I DRITËS, nr. 7, 1923) etj.

⁷⁸ Shkrimi do të citohet sipas Faik Konica, Vepra 1, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001, fq. 243-248.

⁷⁹ Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 287.

kohë. Ky dallim vjen e bëhet edhe më i thellë, jo vetëm në mendimin kritik, por edhe në vlerësimin e veprave të ndryshme letrare, në veprat të cilave ata u referohen dhe për të cilat shkruajnë.

Kështu, deri sa Fishta është i prirë kah klasikët grekë e romakë, Konica përkthen pjesë të epit indas Kalidasa, pjesë nga përrallat arabe Një mijë e një net. Derisa Fishta shkruan ode, elegji dhe himne, Konica shkruan tregime të shkurtra, proza poetike, ese. Derisa Fishta shkruan epin nacional, Konica sprovon romanin dhe kritikën letrare. Derisa Fishta angazhohet për një koncept teologjik për shtetin, Konica angazhohet për demokracinë parlamentare. Derisa Fishta shprehë shumë koncepte mesjetare për organizimin e shoqërisë e të shtetit, Konica është modern në të gjitha pikëpamjet sociale. Kështu, ndoshta fjalët modern për Konicën dhe tradicionalist për Fishtën shprehin më së miri dallimet midis këtyre dy kolosëve të letrave shqipe.

Konica është modern në kuptimin e plotë të fjalës në kritikën e tij:

Kritika është gjykim subjektiv, por i mbështetur në fakte konkrete. Kritika bëhet edhe vetë veper letrare. Në metodologjinë e kritikës Konica mbështetet në përjasje, në krahasimin e vlerës së një veprë me vlerën e krejt kryeveprave të letërsisë botërore. Konica argumenton katërcipërisht se atdheu dhe letërsia janë dy gjëra. Ai ngre zërin, madje parodizon, kritikën e deriatëhershme himnizuese shqiptare.⁸⁰

Në fund Konica e përkufizon kështu rolin e kritikës ndaj letërsisë:

“... se letrëtyra nuk mund të rritet pa një kritikë, e cila nga një anë gatitë këndonjësit për të kuptuar më mirë veprat, nga tjetër anë i bën shkronjësit të shkruajnë me më kujdes.”⁸¹

Edhe pse ka disa gjëra që i përafrojnë interesimet e Fishtës me ato të Konicës në çështje të kritikës, si: edukimi i lexuesit për letërsinë (Fishta, sikurse edhe Konica kritikon lexuesin për mosinteresim ndaj letërsisë⁸²), sikurse Konica që kishte hapur një rubrikë të veçantë për prezantimin e librave shqip në revistën e tij Albania, duke hapur kështu derën për kritikën recensuese në letërsinë shqipe,

⁸⁰ Faik Konica, Vepra 1, fq. 243-248.

⁸¹ Faik Konica, Vepra 1, fq. 248.

⁸² Te Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq. 123.

edhe Fishta hapë një rubrikë të veçantë, të mbiquajtur Bibliografi në Hyllin e Dritës, me qëllim të prezantimit kritik të librave të letërsisë etj; janë katër çështje themelore për mendimin kritik në të cilat dallimet midis Fishtës dhe Konicës janë të mëdha. Këto çështje janë: hapja e letërsisë shqipe ndaj letërsisë botërore, përmes metodës së përqasjes; dallimin midis ideve patriotike dhe letërsisë; kritika himnizuese dhe kritika vlerësuese dhe metoda studimore e kritikës, apo kritika moderne, si mohim i kritikës biografiste.

II.4.4.1. Metoda e gjykimit: hapja e letërsisë shqipe ndaj letërsisë botërore

Duke folur për metodologjinë e kritikës me të cilën Konica do t'i qaset letërsisë në revistën e tij Albania, ai thotë se do të përqsas veprat e autorëve të veçantë me ato që trajtohen në historinë e letërsisë botërore si kryevepra letrare. Edhe nëse kjo përqsasje nuk bëhet e drejtpërdrejtë, ajo ekziston në vetëdijen e kritikut, sepse vetëdija e tij është e ndërtuar mbi vlerat letrare të atyre kryeveprave. Nuk ka dyshim se kjo është një qasje e re në kritikën letrare shqipe dhe qasje e re ndaj veprave e autorëve shqiptarë. Në këtë mënyrë Konica po e hapte letërsinë shqipe ndaj letërsisë botërore, duke i futur veprat e autorët shqiptarë në garë me kryeveprat botërore.

Me këtë metodë gjykimi për letërsinë shqipe, si pjesë e letërsisë botërore, Konica po e absorbonte metodologjinë e studimit historik të letërsisë në Evropë, të filluar me idetë e J. G. Herderit (1744-1803) dhe veprës së tij Këngë popullore (1778-1779) dhe të stabilizuar me esenë e T. S. Eliotit Tradita dhe talenti individual (1919).⁸³

Vetëm një qasje e tillë mund ta bënte letërsinë shqipe pjesë integrale të letërsisë botërore. Deri atëherë autorët shqiptarë kishin krijuar ekskluzivisht për lexuesin shqiptar. Qëllimi më i madh i tyre ishte të bëheshin poetë me famë kombëtare, çfarë e patën arritur padyshim romantikët De Rada e Naim Frashëri dhe pasromantiku Gjergj Fishta. Ç'është e vërteta, De Rada kishte pasur një prirje për ta tejkualuar horizontin e letërsisë shqiptare, duke marrë fjalë lëvdate edhe nga Viktor Hygo (1802-1885)⁴⁸⁰, por e gjithë kjo pati mbetur në kuadër të nismës personale për ta bërë të

⁸³ Zejnullah Rrahmani, Probleme të metodës në shkrimin historiko-letrar, në Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë, 1996, fq. 17-22.

njohur veprën e vet edhe në rrethe jashtëshqiptare.⁸⁴ Veprat e autorëve shqiptarë ishin çmuar nga lexuesi shqiptar, madje edhe në rrethe më to vogla, si është rasti me letërsinë pararomantike shqiptare në gjuhën shqipe. Marin Barleti (rreth 1460-1530) është i pari dhe deri në shekullin XX i fundit shkrimtar shqiptar që ka qenë njëkohësisht autoritet letrar në gjithë Evropën, por ai ka shkruar në latinisht e jo në shqip. Rrethi i lexuesve shqiptarë kishte filluar të kultivohej, e po ashtu edhe autorët shqiptarë. Konica thotë:

“Nuk u shtua shumë numri i librave që dalin, as i këndonjësve; po cilësia e që të dyve u përmirësua.”⁸⁵

Letërsia shqiptare, sipas Konicës, duhej të ballafaqohej në krahasim (përqasje) me vlerat më të larta të letërsisë botërore dhe vetëm atëherë ne do të krijonim një vlerësim real për letërsinë shqiptare.

II.4.4.2. Letërsia dhe Atdheu

Dallimi i letërsisë prej atdheut dhe i poetit prej patriotit është qasja tjetër moderne që e dallon Konicën nga tradita letrare shqiptare.

Derisa Fishta vazhdon me traditën e vjetër të Renesancës italiane për artin si dije e filozofi⁸⁶, duke e marrë shkrimtarin si “mendimtar e filozof”⁸⁷, Konica shkëputë çdo lidhshmëri të poetit me profesionet dhe me fushat e tjera të dijes, si filozofia, etika etj. dhe e shkëputë poetin nga patrioti, poezinë nga atdheu, lidhje kjo tepër e fuqishme në gjithë letërsinë shqiptare, që nga fjalia e parë autoriale e shkrimtarit të parë shqiptar Gjon Buzukut:

⁸⁴ Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 236 dhe fusnota 20, fq. 262.

⁸⁵ J. Kastrati, Studime për De Radën, fq. 301; Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 122.

⁸⁶ Faik Konica, Vepra 1, fq. 243.

⁸⁷ Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 148-149.

“U Doni Gjoni, i biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gja të ndigluomë n së shkruomit shenjtë, n së dashunit së botësë sanë...”⁸⁸

e deri te bashkëkohaniku më i ri i Konicës, Ernest Koliqi, i cili deklaroi:

“Shqipnija ma parë u krijue prej poetënvët në shpirt të Shqiptarvet me kangë qi ngjallshin afshin për liri e mandej u shugurue me gjak të deshmorvet të shtymun m’u ba flije prej atyne kangve.”⁸⁹

Duke bërë këtë shkëputje që nuk është mohim i temës së atdheut në poezi, por vlerësim i poezisë në efektet artistike e jo në argumentimin patriotik, Konica hapë një shteg të ri në letërsinë shqipe për kritikën letrare, duke ripozicionuar edhe kritikën edhe letërsinë në rrjedhën moderne të letërsisë e të kritikës letrare botërore. Kjo shkëputje ka të bëjë në radhë të parë me kritikën. Jo vetëm në kulturën shqiptare, por pothuajse në gjithë kritikën evropiane deri te shkolla formaliste dhe strukturaliste, e të cilat sollën kritikën e tekstit letrar, kritika është kuptuar në lidhje të ngushtë me moralin, me filozofinë, me religjionin, me shoqërinë apo me vetë autorin e veprës. Në këtë prizëm kritika letrare shqiptare nuk është vonuar ndaj kritikës evropiane, ndërkaq koncepti i Konicës për shkëputjen e kritikës nga morali mund të vlerësohet edhe si anticipues.⁹⁰

⁸⁸ Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq. 44, Letër At Pal Dodajt e vitit 1910.

⁸⁹ Meshari i Gjon Buzukut, botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e dytë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968, fq. 387.

⁹⁰ Ernest Koliqi, Fishta interpret i shpirtit shqiptar, fq. 52.

II.4.4.3. Kritika himnizuese dhe kritika vlerësuese

Konica mëton të ndërpresë edhe një traditë tjetër në kritikën letrare shqiptare, do të thosha, jo vetëm në kritikën letrare, por në letërsinë në përgjithësi: kritikën letrare himnizuese dhe stilin himnizues të letërsisë e të kritikës. Studiuesi i letërsisë Sabri Hamit, duke folur për himnizimin si prosede krijues te Naim Frashëri, thotë:

“Himnizimi si prosede krijues u duk në letërsinë shqipe, që te autorët e vjetër, në radhë të parë si himnizim i derivuar i Shkrimit të shenjtë. Në letërsinë e romantizmit dhe në letërsinë e Rilindjes, ky himnizim kaloi në një rrafsh të ri tematik dhe kishte të bënte përgjithësisht me rindërtimin poetik të një të kaluare kombëtare të lavdit e të madhështisë...”

Dhe më tej:

“Po letërsia shqipe nuk është liruar kurrë nga himnizimi si prosede krijues, sa herë është kënduar fati kombëtar, , e kaluara e tij, etosi i tij, etnosi...”

Për të përfunduar:

“Himnizimi është i pranishëm dhe prodhor edhe në letërsinë bashkëkohore shqipe pa marrë parasysh se si prosede i tillë sot edhe nuk ka dhënë veprat më të mira, qofshin edhe nga pena e shkrimtarëve të mëdhenj.”⁹¹

Fishta njihet, si në kritikën letrare, në polemikë e ashtu edhe në poezinë e tij, si kritikues i rreptë i së keqes dhe lavdërues i madh i së mirës. Në kritikën letrare të tij mund të gjejmë edhe gjykime si ky:

⁹¹ Ernest Koliqi, Fishta interpret i shpirtit shqiptar, fq. 52.

“Se një ç’do Nazif O. Mamaqi të çohet e t’botojë poshtersi kso dore, qi poshtnojnë jo veç kombin shqiptar, por njerzimin mbarë...”⁹²

Po në këtë mënyrë ligjërimi të tejkufishëm Fishta edhe i lavdëron veprat e poetët:

“Kto dit kam kndue “Gjermania” të Heine-s. Kurrnji veper letrare nuk më ka ngjallë kaq ndiesi zilije, se sa ky poemth. I mrekullishem! Mundet me e perftyruë si një shenjestore të mbushun plym me zgjeta t’barbarit...”⁹³

Në të dy format e veta, edhe si gjykim negativ edhe si gjykim pozitiv, ky tip ligjërimi i Fishtës është himnizues dhe korrespondon katërçipërisht me ligjërimin himnizues tradicional shqiptar.

Këtë prosede krijues, sa i vjetër, aq i thellë në letërsinë shqipe, mëton ta ndërpresë Konica kur e quan tallje e jo himnizim.⁹⁴ Ai merr një shembull të këtyllë të kritikës himnizuese dhe thotë se nuk do të kishte mënyrë tjetër më të mirë për ta tallur një vepër letrare se sa ta vlerësojë himnizueshëm. Ai gjykon prerat këtë rrjedhë:

“Lirizmi nuk ka punë me kritikën, edhe u lutem këndonjësve të gatiten për një kohëtore më të ftohtë.”⁹⁵

II.4.4.4. Metoda e kritikës letrare-kritika moderne si mohim i kritikës biografiste

Derisa Fishta në konceptet e tij për metodën e kritikës letrare i përket kritikës biografiste të Ipolit Tenit (1828-1893), Konica kapërcen kornizën e autorit dhe kritikën e vlerëson vetëm si një gjykim për veprën letrare. Fishta thotë:

⁹² Umberto Eko thotë: “Ka qytetërimi, i pari nga të gjithë qytetërimi anglosakson, ku-të paktën deri në ardhjen e New Criticism-it- biseda rreth veprave letrare ishte para së gjithash ishte bisedë morale”. Shih te libri Për letërsinë, Dituria, 2007, fq. 159.

⁹³ Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 159-160.

⁹⁴ Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq.139.

⁹⁵ Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq. 156, letër At P. Dodajt, 1908.

“Tue njoftë autorin e një vepre, kritiku e ka ma leht mbasandej me dhanë një gjyq permi vlerë të veprës si mendim, si stil e mandej edhe si qellim. S’mundet me kenë qi shpirti i autorit-edhe me lesh në kjoftëmos ta lajë gjurmen e vet në vepër të tij.”⁹⁶

Ndërsa Konica është krejt tjetër:

“Kritika është një gjykim, -një gjykim i vlerës së librave.”⁹⁷

Asgjë më shumë dhe asgjë jashtë kësaj.

Ne këtu vetëm përmendëm sipërfaqësisht afërsitë e vogla midis Fishtës e Konicës, u ndalëm më përmbajtësisht te tri dallimet themelore, për të vënë re se, edhe pse bashkëkohanikë, të krijuar me idealet e Rilindjes Kombëtare shqiptare, Fishta e Konica janë dy botë të ndryshme letrare. Fishta vazhdon të mbetet edhe në kritikën letrare dhe në konceptet estetike nxënës gjenial i estetikës krishtere të Mesjetës, ndërsa Konica dishepull dhe paralajmërues i modernizmit shqiptar.⁹⁸

⁹⁶ Faik Konica, Vepra 1, fq. 247.

⁹⁷ Faik Konica, Vepra 1, fq. 247.

⁹⁸ Gjergj Fishta, Përndritje/publicistikë, fq. 287-288.

KAPITULLI III. SHËNIME ESTETIKE DHE ESTETIKA E FISHTËS NË VEPRËN “LAHUTA E MALCISË”

“Gjergj Fishta më së miri e ka shprehur shijen estetike në “Lahutën e Malcis” që është shije e kohës e shkruar për kohën, por që do të zgjasë edhe përtej kohës së vet për ta kënaqur edhe shijen e gjeneratave të tjera deri në kohën e sotme.”

Dr. XHAVIT ALIÇKAJ

III.1. SHINIMET ESTETIKE TË FISHTËS

Fishta në veprën e vet “Lahuta e Malcis” ka shkirë vlerat e njëmendta letrare e estetike, të cilat do të bëjmë përpjekje t’i nxjerrim në pah.

Mirëpo, Fishta shfaqti edhe mendimet e tij personale për estetikën. Madje pas veprës së De Radës “Parime të estetikës”, Fishta është i dyti që e begatoi mendimin estetik shqiptar me veprën “Shinime estetike”, me të cilën dëshmoi se ka njohuri për shkencën e estetikës.

Mendimet e tij për çështje estetike i botoi në revistën e njohur “Hylli i Dritës” në numrat 1 e 2 në vitin 1933 me një titull pak më të gjerë: “Shinime estetike: Mbi natyrë t’artit”. Në ato punime Fishta nuk shkroi emrin e plotë, por vetëm shkronjën “A” si një inicial jo i plotë, madje i paqartë. Më vonë, nga shtëpia botuese “Hylli i Dritës” dhe “Shtëpia e Librit”, nën përkujdesjen e Persida Asllanit dhe me një parathënie të shkurtër nga studiuesi shumë i çmuar Aurel Plasari, u botua një si antologji me titull “Fishta – Estetikë dhe kritikë” 1999. Rreth këtij libri dhe përgjithësisht rreth vlerave estetike dhe mendimit estetik të Fishtës kanë shkruar studiues të njohur, si Aurel Plasari, Jakup Mato, Leon Kabashi, Sali Bashota dhe Kujtim Shala, i cili analizon në mënyrë të detajuar veprën “Shinimet”.

Pa pretenduar të merremi me problemet teorike të Fishtës për artin a estetikën, e konsiderojmë të arsyeshme të shkruajmë për strukturën përmbajtësore të librit. Pjesa e parë e librit është emërtuar **Estetikë** dhe fillon me kapitullin “Mbi natyrë t’artit” e me nëntitull - Të bukurit. Vetë koncepti

“Të bukurit” që është thelbi i estetikës, e cila tashmë pothuajse është formuar si shkencë mbi të bukurën - dëshmon se Fishta shpirtërisht ishte i lidhur me të. Ai ishte i vetëdijshëm se kuptimi i së bukurës ishte çështje e ndërlikuar për t’u shpjeguar. Fishta e dinte se, lidhur me mendimin estetik, në periudha të ndryshme, ishin dhënë shpjegime e konceptime të ndryshme, prandaj, para se të shkruante për këtë kategori estetike, kishte pohuar se edhe dijetarëve të njohur, si Platonit, Aristotelit, Akvinit, etj; u ishte dridhur pupla në dorë derisa shkruanin lidhur me këtë çështje.

Fishta pastaj flet për të bukurën artistike, nga e cila, siç thotë ai, lind, ngjallet (ngallit) arti. Po në kapitullin “Mbi natyrë t’artit”, pos së bukurës, i jep rëndësi edhe kategorisë tjetër estetike, të madhërishmes, intuitës, mbresave dhe shijes estetike. Vetë shija estetike lidhet me përshtypjet që na i ngjall një vepër arti a shfaqje e natyrës. Madje në të zë fill shijimi i kënaqësive, po edhe i pakënaqësive të shkaktuara nga realiteti jetësor, a ai artistik. Përkitazi me shijen estetike, një përkufizim të bukur jep esteti i çmuar Tefik Çausi, i cili shkruan: “Shija estetike, është aftësia subjektive, e lindur ose e fituar, për të dalluar e për të gjykuar cilësitë estetike të realitetit, të jetës shoqërore, të veprave të artit, si dhe të sendeve të prodhuara nga njeriu”. (8,424)

Vetë Fishta më së miri e ka shprehur shijen estetike në “Lahutën e Malcis” që është shije e kohës e shkruar për kohën, por që do të zgjasë edhe përtej kohës së vet për ta kënaqur edhe shijen e gjeneratave të tjera deri në kohën e sotme.

Në gjirin e shqyrtimeve estetike Fishta i kushton rëndësi të veçantë fjalës si mjeshtri, pra si art, që e shpreh artin dhe që bëhet objekt i artit. Ndëkaq duke folur për vlerën e fjalës, që gjithsesi i jep shtrirje estetike, pohon se ajo ka peshë, pra vlerë, sidomos kur e thotë njeriu që ka vlera, “Fjala tjetër asht – po e zamë – në gojë të Homerit, të Demostenit, të Ciceronit, të Benjamit, Bossue etj., e tjetër në gojë të ndonji deputati semianalfabet...” (12, 54)

Në vazhdim do të bëjë fjalë për estetikën në folklor tek e cila do ta kërkojë shpirtin e kombit, sigurisht të bukurën, për të kaluar te artet e tjera si lëndë të estetikës: poezia, artet, muzika dhe arkitektura. Përveç kësaj ai flet edhe për estetikën e gjuhës. Vargu dhe e tërë vepra e tij karakterizohen nga bukuria e të shkruarit. Pos asaj që ne e quajmë art poetik, ta kuptojmë tërësinë e këngëve të “Lahutës së Malcis”, Fishta përdor disa formulësime që kanë kuptim estetik dhe semantik, p.sh. vargjet për rrugëtimin e Ali Pashës:

Gjaku turrin ka shpërthy:

Kush dy herë s'i pa me sy. (k.VIII)

ose për një trim tjetër, edhe pse kundërshtar,

T'cillit mrapa s'i merr themra

Prandaj me të drejtë Fishta në "Shinimet" e tij bën fjalë për estetikën e gjuhës. Vetë titujt e punimeve të veprës "Shinime estetike", si: Të bukurit, Bukuria, Madhnia, Mbresat, Shija estetike, Estetika e folklorit, E bukura ne folklor, Estetika e gjuhës, etj; flasin për një leksik estetik të përdorur nga autori.

Duke e çmuar lart këngën kreshnike "Martesa e Halilit", sidomos vargjet ku bëhet përshkrimi më i përsosur i bukurisë së Tanushës do të shkruajë: "Ku e ka Petrarka – mbreti i vjerrshës së bukurisë e të dashtnis – një përshkrim të hijeshisë së grues ma të bukur se ky?". (12,81)

Edhe në këtë vlerësim të tij për këtë këngë në kuadër të Estetikës së folklorit zotërojnë shprehjet "e bukura", "mbreti i vjerrshës së bukurisë", "hijeshia", që janë koncepte estetike, që Fishta i do, i çmon dhe i kërkon në arte.

Duke bërë fjalë për poezinë dhe punën e poetit, që e krahason me bletët që mbledhin nektar lule më lule, poeti kërkon "fjalët e thanjet ma t'hiejshme", pamjet më të bukura si "fusha t'gjana e dete t'kthellta, lypë me gjetë drandofillet ma t'njoma, ujnata ma t'cemta, rudinat ma t'blerta, e flladet e kandshme e ylberët e kjarët (...) e gjithshka toka e deti ka ma t'hiejshëm, ma t'madhrueshëm e ma t'mershem...". (12,87) Kjo është një dëshmi e mirë që tregon se sa e çmon Fishta të bukurën në natyrë, së cilës më vonë do t'i japë shtrirje praktike e artistike në kryeveprën e vet "Lahuta e Malcis".

Gjithmonë te veprat e njohura, qofshin shqipe a botërore, së pari kërkon vlerat estetike. Për veprën e Bogdanit "Çetta e profetëve" veçon këto vlera: "...patrija e gjuhës, hijeshija e thanjeve, pershtatsija e fjalëvet, ritmi e ndërtimi estetik i periudhaves". (12,96)

Ndërkaq "Iliadën" e Homerit, për të cilën thotë se është plot bukur, e vlerëson edhe nga aspekti estetik: "Ideja e naltueshme, e veshme me fjalë të bukura e të pershtatshme, nuk merr mort". (12,102). Dhe po aty duke shkruar për artin oriental thotë: "Më kanë ba pershtypje të madhe edhe miniaturat mbi dorshkrime të Kuranit, si per shumicë si per bukur". (12,107)

Te “Juvenilia” e Mjedës e çmon bukurinë e formës, kurse duke folur për poezinë e Petrarkës dhe përshkrimin e përkryer që i bën bukurisë së Laurës, Fishta thotë se idealin e vet të bukurisë e ka portretizuar: “...tue peshue çdo mendim, tue matë çdo fjalë, tue limue çdo germë; e gjithmonë tue fsha tue rektue mbas sajë, sa qi edhe sod – mbas gjashtëqind – shtatëqind vjetsh – të bahet se po i ndien ato të fshame e të dihame të tijat (...)”. (12,144)

Është e vërtetë se Fishtës shumë i ka pëlqyer vepra e Gëtes “Fausti” të cilën, siç thotë vetë, e kishte lexuar në moshën 19 vjeçare, por e pranon se ajo ia kishte pushtuar zemrën me bukurinë e gjallërinë e vet dhe se i kishte shërbyer si model letrar e estetik: “...për shumë do vjet e mbajta si typin estetik ma të përkryemin ndër ato literatyrë moderne”. (12,147)

Shkrimet e Fishtës janë të kapshme dhe të qarta, sidomos “Lahuta e Malcis” e cila u mësua përmendsh edhe nga malësorët e pashkollë. Si duket si parim krijues, po edhe estetik, Fishta e pati thjeshtësinë: “Në thjeshtësi konsiston gjithë arti i së bukurës letrare, sipas pikëpamjes sime rreth estetikës”. (sipas M. Vuji) (12,307)

Duke çmuar aq shumë estetikën si shkencë, ai ka bërë përpjekje që në shkollat e tij të mbahej edukimi estetik që, sipas tij, do të ndikonte në formimin e të rinjve si njerëz humanë, do të krijojnë dashurinë ndaj arteve të bukura, do të krijojnë ndërgjegjen estetike.

Studiuesi Mark Vuji në veprën e tij “Filozofia arsimore e akademikut Gjergj Fishta” bën fjalë për përpjekjet e Fishtës në edukimin estetik të të rinjve: “Ai shfrytëzoi edhe ekskurzionet në det, në liqe e në rrethina të bukura të qytetit të Shkodrës për t’i njohur nxënësit me vlerat estetike të natyrës. Po kështu edhe vizitat në muze dhe në qendrat historike, Fishta i shfrytëzoi për t’i njohur nxënësit me reliketet e vjetra që ruajnë të derdhur në to shpirtin estetik të krijuesve të brezave të kaluar”. (12,312)

Fishta kishte shpirt prej esteti dhe dije estetike që e tregoi në veprën “Shinime estetike” në aspektin teorik, po edhe në veprat e tjera në aspektin praktik. Në përmbyllje të këtij shkrimi për personalitetin estetik të tij po e citojmë studiuesin e veçantë Aurel Plasari, i cili në parathënien e librit - Estetikë – Kritikë, shkruan: “Mendimi estetik (si edhe ai kritik) paraqitet kështu si një nga dëshmitë magjepëse të atij mendimtari të madh shqiptar, njërit prej më të mëdhenjve që kultura jonë ndonjëherë ka pasur”. (12,29)

III.2. ANALIZË ESTETIKE E LAHUTËS SË MALCIS TË GJERGJ FISHTËS

Ka të tillë që Fishtën e kanë cilësuar si figurën më të madhe dhe më të fuqishme të letërsisë shqipe të gjysmës së parë të shekullit XX. Studiuesit si Eqrem Çabej, Benedikt Dema, Françesko Ercole, Maksimilian Lamberci, Zef Skiroi, Ernest Koliqi, Georg Shtadmyleri, Zef V. Nekaj, Xhuzepe Gradilone, Ignjac Zamputi, Tonin Çobani, Aurel Plasari, etj; janë marrë me krijimtarinë letrare të Gjergj Fishtës në periudha të ndryshme: para Luftës së Dytë Botërore, pjesërisht gjatë luftës, pas luftës, pra, në vitet 1945-91, si dhe në periudhën e pluralizmit politik. Siç dihet, në vitet 1945-1990, krijimtaria letrare e Fishtës në Shqipërinë moniste nuk ka qenë lëndë studimi e kritikës letrare shqiptare. Në periudhën në fjalë, vepra e Fishtës është studiuar në mënyrë të njëanshme dhe me kritere jashtëletrare dhe joartistike.

Me krijimtarinë e Fishtës janë marrë studiues shqiptarë, por edhe studiues të huaj, sidomos italianë, austriakë dhe gjermanë. Sipas studiuesve të sipërthënë të veprës fishtiane, Fishta, më shumë se cilido krijues tjetër, i ka dhënë shprehje artistike shpirtit kërkues të shtetit të ri sovran shqiptar. I dëgjuar e i ngritur lartë deri në vitin 1941 si “poet kombëtar i Shqipërisë” dhe si “Homeri shqiptar”, pas vitit 1945 Fishta menjëherë ra në harresë. Edhe vetëm përmendja e emrit të tij, ishte një tabu për shqiptarët, që zgjati pothuajse gjysmë shekulli. Në periudhën para Luftës së Dytë Botërore, Fishta cilësohej si zëri i kombit.

III.2.1. Si lindi Lahuta e Malësisë

Më 1902 Fishta ishte dërguar në një fshat të vogël për të zëvendësuar përkohësisht famullitarin vendor. Atje u njoh me fshatarin e moshuar Marash Uci (vdiq më 1914) nga Hoti, të cilin do ta përjetësonte më vonë në vargje. Marash Uci i rrëfente Fishtës për betejat heroike midis malësorëve shqiptarë dhe malazezë, në veçanti për betejën e famshme në Urën e Rrzhanicës, ku Marash Uci kishte marrë pjesë vetë. Pjesët e para të poemës me titullin Te ura e Rrzhanicës, u botuan në Zarë më 1905 e 1907. U ribotuan të zgjeruara më 1912, 1923, 1931 dhe 1933. Fishta i shkruante këngët e tjera të cilat filloi t'i botonte që nga viti 1921 në revistën që drejtohej prej tij - Hylli i

Dritës. Botimi përfundimtar i poemës me 30 këngë dhe 15.563⁹⁹ vargje u paraqit në Shkodër më 1937 në kremtim të 25-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Poema përmban 1274 fjalë të rralla.

Verbi (fjala) fishtiane i përcjell notat muzikore të instrumentit të lahutës me përsëritjet e tingujve të fjalëve dhe të strukturave sintaksore; me epitetet, krahasimet, similitutat¹⁰⁰ dhe hiperbolat; me metaforat, simbolet dhe mitemat¹⁰¹; me pyetjet dhe përgjigjet, me pyetjet retorike, pasthirrmat, etj.

Poema ka një strukturim të hapur gjuhësor dhe ritmik (aliteracioni, rima, ritmi i këmbëshëm brenda njësisë metrike dhe ndërmjet vargjeve).

Kjo poemë epike u ribotua në Romë më 1958, në Lubjanë më 1990 dhe përsëri në Romë më 1991. Lahuta e malësisë është përkthyer edhe në gjermanisht dhe në italisht.

III.2.3. Lahuta e Malcis

Poema nis me përleshjet kufitare midis fiseve të Hotit e të Grudës dhe fqinjëve po aq të rreptë malezëzë më 1858. Thelbi i veprës janë këngët 6-25 që u kushtohen ngjarjeve të viteve 1878-1880, që lidhen me Kongresin e Berlinit, i cili i dha toka kufitare shqiptare Malit të Zi dhe çoi në krijimin e Lidhjes së Prizrenit për të mbrojtur interesat e kombit. Këngët e tjera mbulojnë periudhën e revolucionit të xhonturqve, i cili në fillim u ngjalli shpresa nacionalistëve shqiptarë për një autonomi, si dhe luftërat ballkanike të viteve 1912 dhe 1913, që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Lahuta e malcis, me synimin që të bëhej epike kombëtare, e kapërcen stilin baladesk të De Radës dhe tregimin historik të Naimit, duke u derdhur me një vrull epik dhe dramatik. Duke qenë se poema u shkrua për një kohë të gjatë, ajo nuk e ka të njëjtën fuqi në çdo këngë veç e veç, ashtu siç nuk ka dhe një strukturë të lidhur në vazhdimësi. Në variantin përfundimtar, autori krijoi një

⁹⁹ Shkrimi do të citohet sipas Faik Konica, Vepra 1, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001.

¹⁰⁰ Aliçkaj, Dr. Xhavit, Lahuta e Malcisë e Gjergj Fishtës, Faik Konica, Prishtinë, 2000

¹⁰¹ Aliçkaj, Dr. Xhavit, Lahuta e Malcisë e Gjergj Fishtës, Faik Konica, Prishtinë, 2000

renditje kronologjike për ndodhitë shqiptare nga gjysma e shekullit XIX deri në pavarësinë e Shqipërisë dhe Konferencën e Londrës, më 1913. Në poemë pasqyrohen luftërat e dy brezave, mirëpo këngët e saj më tepër tregojnë ngjarje të veçanta. Nuk është një poemë që ka një veprim kryesor dhe një hero kryesor, siç janë eposet e mëdha. Heronjtë e Lahutës janë të shumtë dhe nga ana funksionale janë të ngjashëm në vepër, për arsye se i kanë karakteristikat e heroizmit shqiptar.

Vepra nis me heroizmin e shqiptarëve për të mbrojtur tokat e tyre nga sulmet e malazeziasve, të përqendruara në Shqipërinë e veriut. Ajo vjen duke u zgjeruar në hapësirë dhe në kohë për t'i kapur ndodhitë dhe cilësitë shqiptare. Nga fokusimi i një krahine vepra zgjerohet në tërësinë etnike shqiptare. Nis me trajtimin e burrërisë së një mjedisi për të arritur te koncepti i burrërisë si virtyt kombëtar.

Në këtë mënyrë Lahuta e malcis bëhet vepër për himnizimin e virtyteve të përhershme të shqiptarëve si dhe projekt i idealeve të poetit. Duke u mbështetur në jetën autentike shqiptare, me mjediset reale e fantastike të mendësisë shqiptare si dhe me kërkimin e modelit të shkrimit që mbështetet në letërsinë popullore shqiptare, poema epike e Fishtës synon të ngrihet në nivelin e eposit kombëtar.

Pavarësisht nga fakti se poeti mbështetet në modelet krijuese të letërsisë popullore, Lahuta e malcis është një vepër e kulluar autoriale.

Poema përmban tre tipa këngësh:

- këngë historike, si Vranina, Kongresi i Berlinit, Lidhja e Prizrenit, Lufta e Ballkanit, Konferenca e Londonit të cilat janë të ngjashme me këngët popullore historike. Në to ngjarjet historike pasqyrohen në kohë;
- këngët kreshnike, ku shpërthimet krijuese imagjinatave shpiejnë te cikli i kreshnikëve apo te baladat popullore. Në to fantazia krijuese e poetit ndërtohet mbimitologjinë shqiptare (Orët, Zanat, Dragonjtë);
- këngët autoriale, si Patër Gjoni apo Tringa, ku imagjinata e poetit, edhe kur mbështetet në tekstet e baladave, i shndërron ato në stilin vetanak. Te këto këngë vepron fantazia e autorit, por edhe mendësia e tij që del në vepër në trajtën e porosisë përfundimtare. Kjo formë e krijimit i prek edhe heronjtë e veprës: përballë Oso Kukës së patrembur, i cili për atdheun në çdo çast është i gatshëm të flijojë veten, model ky popullor i therorisë

shqiptare, shfaqet Abdyl Frashëri – hero i ideologjisë kombëtare, apo Naim beu (Frashëri) – hero i kulturës shqiptare (në këngën origjinale të Patër Gjonit). Shfaqet edhe heroina Tringa, e cila, bashkë me flijimin për atdheun, shpalos një bukuri, dashuri, virgjëri dhe pafajësi, duke u kthyer kështu në një krijesë poetike burimore të Fishtës.

Lahuta e malcis është një vepër epike me një ndërtim të brendshëm dramatik, ku spikatin veprimet, dialogu, përshkrimi i shkurtër dhe gjuha e folur, e cila, duke u kthyer në gjuhë të shkruar, i ruan shenjat e emocioneve të personazheve. Duke iu përmbajtur këtij modeli dhe këtij stili, poeti vë në tekstin e tij format e dendura apo të shkurtra të letërsisë gojore, jo si citat, por si mbindërtim, rëndom më fuqishëm – në trajtën e urimeve dhe të mallkimeve.

Një nga figurat zotëruese të poemës është hiperbola me të cilën poeti përshkruan ngjarjet dhe pamjen fizike të personazheve. Kjo figurë është ndërtuar rëndom duke marrë për bazë krahasimin.

Faqe tronditëse të poemës janë ato ku bashkohen dhe harmonizohen veprimet epike me shpërthimet lirike dhe me lirinë e imagjinatës së autorit, duke krijuar kështu një dramacitet të fuqishëm. Të tilla janë këngët që ndërlidhen me heroinën letrare – Tringën. Këtu bashkohen idealet e poetit: trimëria dhe atdhetarizmi deri në flijim; bukuria dhenjomësia që rrezatojnë dashuri; pasqyrimi i moralit të femrës shqiptare dhe tragjizmi i saj. Të gjitha këto lidhen në një orkestrim të habitshëm e të magjishëm të natyrës.

Në veprat e tij epike, poeti manifestoi një forcë të madhe lirike, ngase atje kishte mundësi. Vetëm mjedisi shqiptar i krijonte mundësi poetit të shfaqte shpërthimet personale, si karakteristika të lirikës së tij.

Poeti u mbështet në modelin e Këngës së Gjergj Elez Alisë. Në këngën e Fishtës veprimi është invers: i sëmuri (vëllai) vdes dhe mbetet Tringa (motra), e cila mbron nderin, pragun, bukurinë e saj të paprekur, virgjërinë dhe botën poetike të Fishtës. Në këtë mënyrë, ajo i dorëzohet jo vdekjes, por pavdekësisë. Ajo që ndodh më tej me Tringën, është endje e imagjinatës së poetit në botën e mitologjisë shqiptare. Heroina shkon te simotrat e saj –zanat. Cikli i këngëve për këtë heroinë zbulon mënyrën se si poeti e ndërton Lahutën e malësisë: ngjarja apo ndodhia reale, me anë të frymëzimit lirik, kalon në shkallën e përgjithësimit dhe të idealizimit. Çdo gjë që është burimore shqiptare ngrihet në nivelin e përjetësisë, si kërkesë morale, jetësore

dhe artistike e poetit. Një portretizim të tillë fizik dhe moral të bukurisë me anë të figuracionit popullor, poeti e bën pikërisht te personazhi i Tringës.

Sipas disa studiuesve, kryevepra e Fishtës – Lahuta e malcis, është e papërsëritshme në letërsinë shqiptare. Ajo pasqyron në mënyrë të sistemuar kulturën dhe historinë autentike të shqiptarëve me anë të shprehjeve të pasura gjuhësore, si dëshmi e jetës shqiptare edhe në lëmin e gjuhës. Vargu i poemës, tetërrokëshi i ngjashëm me vargun më të njohur popullor, ndikoi që poema të fitojë një popullaritet të shpejtë.

Vepra ka një histori të gjatë shkrimi dhe leximi që kanë ndikuar te njëra-tjetra. Këngët e para të poemës autori i botoi si këngë popullore. Por, lexuesi i priti ato më me endje se krijimet e tjera të tij. Me fjalë të tjera, shija e lexuesit, u bë frymëzim shtesë që autori ta vazhdojë dhe ta përfundojë veprën. Mirëpo, Fishta nuk do të ishte i madh, sikur të mos e tejkalonte shijen e kohës. Në këngët popullore, poeti gjeti vetëm modelin e komunikimit, ndërkaq këndvështrimi për qenësinë shqiptare është i vetë poetit.

Në poemën epike, Lahuta e malësisë, kemi personazhe historike si: Oso Kuka, Ali Pashë Guçia, Abdyl Frashëri, Marash Uci, Çun Mula, Haxhi Zeka, Pater Gjoni, Bec Patani, Tringa, Dedë Gjon Luli. Fishta na jep edhe figura historike të huaja si: Franc Jozefi i Austro-Hungarisë, Vilhelmi i Gjermanisë, Krajli i Inglizit, Regji i Italisë, etj.

Përballë tyre, autori i poemës na jep figurat historike të palës kundërshtare, si: knjaz Nikolla, Mark Milani, Vulo Radoviqi, Mil Spasi, Mehmet Ali Pasha, Abdullah Pashë Dreni, Turgut Pasha; cari i Ruisë, kreu i Francës, etj.

Poeti na i jep në poemë edhe figurat mitologjike: Ora e Shqipnisë, Ora e Bardhë e Trojanit, Zana e Durmitorit, Zana e Miliskaut, Zana e Veleçikut, Zana e Madhe, Zana e Frymëzimit, Ora e Durmitorit, dragonjtë, kuçedra, etj.

Për poemën mund të nxirren disa konstatime por edhe ca dilema, si:

- Uniteti i poemës duhet gjetur te fryma e kombit e cila ka bashkuar njerëz, fakte dhe ngjarje të Rilindjes deri në pavarësi;
- Mjetet artistike për krijimin e poemës janë marrë, qoftë nga eposi i lashtë shqiptar, qoftë nga tradita homerike;

- Mbështetja e poemës në eposin e lashtë duhet kërkuar në motivet tradicionale që i përshtaten lëndës bashkëkohore, në mendësinë kanunore që i përshtatet më së miri mendësisë bashkëkohore, duke himnizuar besën dhe burrërinë me gjuhën burrërore të Këngëve të kreshnikëve;
- Lidhjen me traditën homerike të Lahutës fishtiane duhet kërkuar në situatat e veçanta të kënduara në poemë me figuracion dhe përmasë homerike;
- Bota mitologjike e poemës duhet studiuar në dukurinë funksionale të saj: zanat dhe qeniet e tjera të mitologjisë sonë (Lugati, Kulçedra, Dragoi etj.) a janë te Fishta me funksionin që kanë hyjnitë te Homeri, ku njerëz, fakte dhe ngjarje shpesh varen prej kapricave të hyjnive;
 - Figuracioni, a i ka ato përmasa hiperbolike siç e kërkon epika tradicionale dhe siç e kanë Këngët e kreshnikëve, ku topuzi ngulet 12 pash nën dhe, dhe 12 pash përpjetë ngrihet pluhuri.

Parimet nga të cilat u udhëhoq poeti për krijimin e eposesë së shqiptarëve janë një sintezë e poetikës aristoteliane me shkollën romantike të Evropës perëndimore të shekullit XIX.¹⁰² Duke qenë se Fishta bazohet te klasikët greko-romakë, poema epike e tij Lahuta e malcis është vepër neoklasiciste.¹⁰³

Vargu epik i Fishtës këmbëhet me pasazhe lirike pa më të voglin kufizim dhe si tablotë rrëqethëse tragjike që mbizotërojnë në vepër, filtrohet në të, një ironi e hollë.

Përveç konfliktit shumëpalësh, që herë zgjerohet e herë qendërzohet dhe subjektit të pasur me episode dramatike, në poemë veprojnë edhe qindra personazhe të individualizuara që e shpalosin karakterin e tyre me veprime heroike, përballë kundërshtarëve dhe krahas bashkëlufëtërëve e qenieve mitologjike. Fati i tyre është i përcaktuar historikisht, manipulohet nga mbretër e diplomatë, mbrohet ose braktiset nga Orët e Zanat dhe në çastin e fundit, ndodhet në dorën e vetë atyre, pikërisht si fati i atdheut. Këndeje buron ndoshta edhe mesazhi më optimist i eposit fishtian. Mesazhi i poetit është mesazhi i krijuesit artistik të frymëzuar nga Zana mitologjike, mesazhi i përjetimeve vetjake nga kontaktet me thellësitë e shpirtit njerëzor të një fisi që ka mbetur i pacenuar

¹⁰² Shih për afërsinë e neoplatonistëve me krishterimin në librin Rrëfimet të Shën Augustinit, Plejad, Tiranë, 2006

¹⁰³ Po aty.

prej ideologjive të huaja. Ky mesazh optimist vjen si një ndjenjë që përftohet nga skajshmëritë e dhimbjes dhe të krenarisë, të zhgënjimit dhe të kokëfortësisë, të pasionit dhe të stoicizmit, të arsyes dhe të instinktit, të qytetërimit dhe të primitivizmit.

Trajta tregimtare, e gërshetuar me dialogje të gjata, i mundëson poetit të përcjellë një informacion të gjerë etnografik dhe një dendësi të thellë mendësish kontradiktore. Përshkrimet e dhjetëra betejave me hollësi tronditëse janë tabllo të gjalla, ku vijnë në kontrast ngjyrat natyrore të peizazhit në orë të ndryshme të ditës apo të natës, të ngjeshur me ngjyrën e kuqe të gjakut, që kullon nga kokat e prepra dhe nga baruti i djegur, përzier me kundërmim kufomash kundërshtare. Betejave të individualizuara u paraprijnë kuvendet e trimave, debatet e diplomatëve, prapaskenat e mbretërve, të shfaqurit e qenieve mitologjike, që për nga veprimet dhe gjykimet, me të madhe u ngjajnë njerëzve.

III.3. VLERAT ESTETIKE TË “LAHUTA E MALCIS”

Për fat të mirë, kanë ndryshuar kohërat. Janë bërë kthesa të mëdha edhe në jetën kulturore e sidomos letrare. Të gjithë ata që dikur u dënuan, u ekzekutuan dhe u përjashtuan nga letërsia i janë kthyer djepit të kulturës kombëtare letrare. Janë me dhjetra emra të shkrimtarëve të njohur, të cilëve dikur nuk kemi guxuar tua përmendim emrat, t’ua lexojmë a studiojmë veprat. Njëri ndër ta- ndoshta ndër më të mëdhenjtë- ishte edhe Gjergj Fishta, ose siç e quante Ernest Koliqi “Këngëtar qi ndigjoi të rrahmet e zemrës së Shqipnis”.

Kur flasim për Fishtën, mendja na vete menjëherë te vepra e tij madhore “Lahuta e Malcis”. Ndonëse janë bërë studime nga më të ndryshmet për veprën e tij nga emra të njohur, që e nderojnë shkencën e letërsisë, ndonëse edhe autori i këtyre rreshtave ka bërë një studim monografik, mendojmë se nuk është thënë e tëra. Mendojmë se kjo vepër gjithnjë të nxitë për të thënë diçka të re, sepse krijon ndjenja të veçanta estetike.

Ernest Koliqi, me rastin e rileximit të saj, do të shkruajë: “ Nji shije të re, nji amsim të papritun ndjeva n’at lexim: e, pra, ato vargje i njifshe e i stërnjifshe. Por tashti ato më dhurojshin ndijime nji lloji tjetër”. (26,27)

Dhe i rikthehemi “Lahutës së Malcis” duke krijuar ndjesi dhe ndjenja të tjera estetike. Për t’i çelur portat e artit letrar dhe vlerat estetike, duhet hapur perdja e E. Koliqit që na e nxjerr përpara bukurinë dhe madhështinë e veprës: “Ndëgjoje hapin kumbues t’Oso Kukës kah i bjen pash e në pash Pazarit të Shkodrës, ndigjoji troket e dhënve e të dhive të Marash Ucit e të bijve të Colit që kullosin nëpër bjeshkë, vënja veshin ligjirimit të flatruem t’Abdyl Frashërit në Kuvend të Lidhjes së Pezrendit edhe vajit t’Orëve e të zanave mbi trupin e pashpirt të Tringës së vrame prej anmikut, lëshoju në rrëmbim të vargjeve tingullore edhe Shqipnija, me male e me fusha, me pyje e prroje ka për të hy mbrendë në dhomë prej dritareve të hapuna”. (26,61)

Bashkëkohësit e Fishtës thonë se përshkrimet estetike e madheshtore në veprën “Lahuta e Malcis” përkonin me bukurinë e madhështinë e tij si person fizik. Bashkëkohësit dhe njohësit e tij, e përshkruajnë me ngjyra të veçanta personalitetin fizik të Fishtës.

Madje kjo ka bërë që vepra e tij letrare t’i kapërcejë të gjitha pengesat e mëdha politike dhe të ruhet ndër gjenerate deri në ditët tona. Bukuria e tij fizike e shpirtërore kanë ndikuar në atë letrare që me po atë shije është ruajtur nëpër gjenerata duke i mundur pengesat e mëdha politike. Pal Dukagjini në veprën e tij “Gjergj Fishta – jeta dhe veprat” i bën një përshkrim të rrallë në kapitullin “Fizionomia e Fishtës”:

“Qafën, gjoksin e shpatullat Atë Gjergji i kishte si Ilirët e vjetër, posi nipat e tyre tipikë të Maleve tona të Veriut. Kur rrinte në këmbë dukej si shtyllë bajraku a si pirg fortese; kur ulej në karrigë, të çonte mallin e patricëve romakë ndejun në Kurie”. (26,171)

Patër Anton Harapi, bashkëmendimtar, bashkëkohës i Fishtës, shkrimtar e urtak, e quan Fishtën njeri me shpirt esteti. Ai, duke i peshuar mirë vlerat e veprës së tij e në veçanti vlerat e “Lahutës së Malcis”, shkruan: “Ai mori prej popullit gjithshka gjet të hijshëm, të madhnueshëm e të fuqishëm, e porsì një piktor i zoti, e shndroji në shpirtin e vet, tue riprodhues në mënyrë, e cila asht vetëm e tija, prandej origjinale”. (15,49)

Patër Leon Kabashi: “Lahuta asht një pinotekë e artit kombëtar, ku Poeti pikturon gjallë tipat, personazhet, skenarët e kostumet”. (15,55)

“Lahuta e Malcis” lirisht mund të konsiderohet si një përmendore estetike, ku vlerat e dukuritë estetike shkrihen shumë natyrshëm, sa që me të nuk mund të maten veprat e tjera të kohës, ndoshta

as të shekullit! Sali Bashota: “Vepra “Lahuta e Malcis” e degëzon qëndresën shqiptare në rrjedhën e përcaktuar kohore e historike. Këngëtimi i saj, mbase mund të bëhet himn i atdhetarisë së kulluar, shkallë sipërore e vetëdijes kombëtare, kult i heroizmit shqiptar”. (3,34)

Fishta një kohë të gjatë kishte hamendësuar për ta shkruar “Lahutën e Malcis”, po ashtu gjatë kishte hamendësuar për formën dhe përmbajtjen e saj, si do të dukej dhe si do t’ia përshtaste shijes së lexuesve. Në fillim ai shkroi ndonjë këngë për ta parë sesi do të bëhej receptimi i tyre. Madje, ai edhe u fsheh pas tyre duke i quajtur këngë popullore. Kështu këngë pas kënge duke mbajtur nën mbikëqyrjen artistike lidhjen dhe harmoninë e tyre, më në fund e shkroi, hiç më shpejt se për 30 vjet!

Prandaj “Lahuta e Malcis” doli një vepër e përkryer, mbi shoqet, e shkruar me shije të veçantë, me mjeshtri të veçantë dhe e begatuar me vlerat më të larta ideore dhe estetike, gjë që është parim qenësor krijues i çdo shkrimtari.

“Prandaj me të drejtë Fishta në “Shinimet” e tij bën fjalë për estetikën e gjuhës. Vetë titujt e punimeve të veprës “Shinime estetike”, si: Të bukurit, Bukuria, Madhnia, Mbresat, Shija estetike, Estetika e folklorit, E bukura ne folklor, Estetika e gjuhës etj., flasin për një leksik estetik të përdorur nga autori”

Përkritazi me këtë çështje esteti ynë më i njohur Alfred Uçi shkruan: “Çdo artist përpiket që temën ta trajtojë në mënyrë estetike, ta vlerësojë estetikisht dhe në përputhje me idealet e tij social-estetike, në prizmën e kategorive estetike të së bukurës, të së shëmtuarës, të së madhërishtes ose të së ultës, tragjikës ose komikës. Kjo gjë tregon se në veprat artistike duhet të ketë vlera jo vetëm forma, por edhe përmbajtja e veprës, d.m.th. duhet që tema të jetë konceptuar sipas ligjeve të së bukurës” (36,176)

Pa dyshim që “Lahuta e Malcis” i ka të mishëruara harmonishëm këto vlera estetike, sepse ai vetë mbështetet në ato vlera: në estetikën e veprave klasike e moderne të kohës, në estetikën e folklorit, po edhe në vlerat estetike të mitologjisë.

Për këtë arsye “Lahuta e Malcis” është ndër veprat e rralla që të zgjon ndjenja kënaqësie sa herë që e lexon; ndjenja të tilla të zgjon çdo këngë e saj veç e veç dhe secila të krijon një forcë të re dhe

vullnet për jetë, një shpresë që nuk shuhet dhe dashuri të pashterrshme për atdheun dhe kombin shqiptar.

Estetika e Fishtës, që gjeti shprehjen më të mirë në veprën “Lahuta e Malcis”, ka mbështetje të thellë në psikologjinë e popullit, në shpirtin e tij, në ndjenjat dhe përjetimet e tij nëpër ato thyerje të rrepta historike. Gjithashtu ka mbështetje në etnicitetin e popullit ku shfaqen doket e zakonet, trimëria e urtësia, dashuria e urrejtja.

Fishta, duke u marrë edhe vetë me çështje estetike, me koncepte estetike, u përpoq që jetën dhe të gjitha ngjarjet e përfshira në “Lahutën e Malcis”, t’i shijonte me masa estetike, prandaj, në mbështetje të këtij parimi, në veprën e tij futi çdo gjë që ishte fisnike, e bukur dhe e lartë.

“Lahuta e Malcis”, me gjithë ato pamje të tmerrshme, me luftëra të përgjakshme, me vrasje, vuajtje e dhembje, ka diçka në brendinë e saj që ta nxehtë gjakun, që të bën të mos i ndahesh, të bën të të zgjohen llojlloj ndjenjash, po gjithnjë kënaqësie, që na bëjnë t’i shijojmë në mënyrë të veçantë.

Këngët e “Lahutës së Malcis” mund të lexohen sipas dëshirës, d.m.th. mund të fillosh nga cilado këngë, sepse, sa i përket ndërtimit të saj artistik, paraqesin një tërësi organike, sepse ato i lidh “peni i Ariadnës”. “Lahuta e Malcis” është Lahutë vetëm si tërësi. (Sipas legjendës peni i Ariadnës e nxori Tezeun nga labirinthi).

Por sa u përket çështjeve estetike të formës e të përmbajtjes, estetit të nderuar Tefik. Çaushi i thyhet qerrja te Fishta: “Në elementet e formës, poezia e Fishtës kishte mjaft tipare të letërsisë orale popullore dhe e krijonte lehtë përshtypjen e një krijimi “kombëtar” shqiptar. Porse në përmbajtjen e saj ajo ishte antishqiptare, antikombëtare dhe reaksionare, për arsyet që dihen” (7,47)

Ky mendim për kohën ishte i arsyeshëm dhe i pranueshëm dhe ato thonjëza te fjala “kombëtar” dhe te shprehja “për aryet që dihen”, janë thënë pa dëshirën e autorit. Tefik Çaushi, një njohës i mirë i estetikës, e di se nuk është ashtu, se pikërisht përmbajtja dhe forma e “Lahutës së Malcis” janë krejtësisht kombëtare. Aty gjejmë shpirtin luftarak të popullit tonë, që është karakteristikë e epeve nacionale, siç do të thoshte Hegeli.

III.4. VLERËSIMET PËR LAHUTËN E MALCIS DHE PËR FISHTËN

Eqrem Çabej:

“...Fishta zë fill me njësinë e vogël të fisit për të mbaruar te njësia më e madhe e kombit, ia fillon me bariun e moçëm Marash Ucin dhe mbërrin te Abdyl Frashëri në Lidhjen e Prizrenit. Duket qartas përpjekja e tij të zgjerojë dalëngadalë botën në një brendi më fort nacionale, të ngrejë kështu veprën në sferën kombëtare. Kështu vepra e tij ka marrë karakterin e një eposi kombëtar...duke qenë njëkohësisht në një farë kuptimi edhe një epos ballkanik. Një dritë jete homerike shkëlqen mbi veprën e tij: si në dukje të zanave që u përngjajnë Dianës e Atenës...”

Katër vjet para se të vdiste Fishta, Çabej jep këtë gjykim:

“Gjergj Fishta është bërë, sidomos në Lahutën e malcis, përfaqësuesi më i parë i literaturës së sotme shqiptare”.¹⁰⁴

Lasgush Poradeci:

“Shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar, ky është si të thesha “monopoliteti” gjenetik i artit të Fishtës, kështu do t’i thesha me dy krahasime paralele gjithë poezisë që na ka falur ky vigan i kombit...”¹⁰⁵

Kostaq Cipo:

“Tetërokëshi i ngadalshëm e vrap e vrap, si e lyp zjarri i zemrës, asht i premë për poemë epike. Me këtë ritëm janë pre ngjetmi e pashoq fishtian, thërrmënitë e forta, uratat e mallkimet...”¹⁰⁶

Sterjo Spasse:

¹⁰⁴ Eqrem Çabej, “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, shtëpia botuese “MÇM”, Tiranë, 1994, f. 26.

¹⁰⁵ Eqrem Çabej, vepër e cituar, f. 26.

¹⁰⁶ M. Edith Durham, “Twenty Years of Balkan Tangle” Londër, 1920, f. 124. Cituar nga Faik Konica, “Vepra”, f. 392.

“Lahuta e at Fishtës shfaq ndjesitë më të thella dhe karakteristikat më të kristalizuara që i ruajti raca shqiptare përmes shekujve plot shtrëngata... Shqipëria e tërë përfshihet e dehur nën vargjet e kësaj Lahute, e cila bëhet pronë kombëtare, mish e gjak, ndjenjë e mendim i përbashkët”.¹⁰⁷

Ernest Koliqi:

“Tue lexue Lahutën e tij, (të Fishtës – Xh.Z.) përplot me teprica kangësh rapsodike të pa emën, të duket se je tu e vështruar popullin shqiptar kah i këndon vedvetit, me fjalët e Fishtës, ma të kulluetën kangë, e cila shpërthen nga një gjak misterioz, që rrjedh në zemrën e tij ilire”¹⁰⁸

Faik Konica:

“Atë Fishta është marrë me secilën gjini letrare dhe në të gjitha ka qenë i suksesshëm. Mirëpo, jashtë Shqipërisë ai është i njohur vetëm si autor i Lahutës së malcis – një epike pastorale e kalorësiake, përkthimi gjerman i së cilës, i botuar në Lajbcig para disa vitesh, të lë një përshtypje të dobët, meqë nuk ka qenë e mundur të përkthehet muzika e ritmit të Fishtës dhe koloriti i tij verbal”.¹⁰⁹

Viktor Volaj (1910-1995):

“Shqiptari nuk ka nevojë t’i krijojë vetes një histori për me u afirmua. Bota e Lahutës së malcis asht shfaqja më e sigurt e shpirtit të tij heroik e fisnik”.¹¹⁰

Vehbi Bala:

¹⁰⁷ Paul Edmonds, “To the Land of the Eagle”, Londër, 1927, f. 78. Cituar sipas Faik Konica, “Vepra”, f. 392.

¹⁰⁸ Eqrem Çabej, vepër e cituar, f. 32-33.

¹⁰⁹ Faik Konica, “Vepra”, f. 161.

¹¹⁰ Viktor Volaj, Parathanje, fq. 27-32;

“Me gjeninë e tij, Fishta ka ditur ta shfrytëzojë me plot fantazi thesarin e popullit dhe duke i shtuar atij trillin e vet krijues, ka arritur në majat më të larta të artit poetik të letërsisë sonë”.¹¹¹

Daniel Gjeçaj:

“Fishta, çmos kurni shkrimtari tjetër të Rilindjes sonë, aq i hini shpirtit shqiptar, që në fund të fundit ishte dhe shpirti i tij... Fishta këndohej pa ditë se si i thojshin emnit: këndohej pse në kangë të tija ishte shqiptari: shqiptari në doke, në kanu, në mitologji, në folklor, në aspirata, në jetë, në luftë e në ngadhënjime... Shqiptari pa Lahutë (të malcis – Xh. Z.) asht pa epokë kombëtare: Lahuta pa shqiptarë asht pa subjekt”.¹¹²

Engjëll Sedaj:

“Vargjet e Lahutës mund t’i lexosh në fillim, në mbarim, në mjedis apo në çdo mëngjes para se të fillosh punën ditore. Ato të japin fuqinë e jetës, fuqinë e punës, sepse mobilizojnë të gjitha ndjenjat e shpirtit... Aq shumë imponohet kjo vepër, saqë disi kurrë më nuk e heq nga dora... Poeti ka arritur të mishëronte të gjitha ligjshmëritë artistike në poezinë popullore, sidomos në përdorimin e figurave stilistike të krahasimit dhe të metaforës”.¹¹³

Anton N. Berisha:

“Nga poezia gojore Fishta mësoi dhe shfrytëzoi atë që kuptimisht ishte më e rëndësishme, artistikisht më e vlershme dhe me mundësi ndikimi estetik më të madh, por çdo gjë duke ia nënshtruar sistemit të vet krijues, asimilimit në shkallën dhe mënyrën më të lartë, qoftë

¹¹¹ Fishta, Piksime estetike mbi artin e fjalës, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003.

¹¹² Po aty

¹¹³ Kujtim M. Shala, Shinimet e Fishtës, AIKD, Prishtinë, 2002.

edhe atëherë kur në të parët fitohet përshtypja se në veprën e vet ka futur pjesë të tëra të poezisë gojore”.¹¹⁴

Gjergj Zheji:

“Te Fishta ndihet një vargëzim në të njëjtën masë sa poeti erudit, aq edhe rapsodi popullor, që di të krijojë me dorë të sigurt dhe shije të rrallë artistike orkestrimin e muzikalitetit të vargjeve dhe të verbit të tij të pashtershëm poetik”.¹¹⁵

Norbert Jokli:

“Ai hyri aq thellë në shpirtin e këngëtarëve të maleve shqiptare dhe diti të karakterizojë në mënyrë të dhimbshme dhe të sigurt artin, botën ideale e gjithëmbarrësisht të gjitha veglat e armët e rapsodëve që gjenden edhe ndër më të skajshmet krahina të maleve. Vetëm ai që gjendet në mes të kësaj bote mund të ndiente aq thellë zemrën e të rrahmen e diellit të këngëtarit kombëtar shqiptar, mund të kuptonte aq mirë e qartë mendimin e tij”.¹¹⁶

Maksimilian Lamerc:

“...Lahuta e malcis e Gjergj Fishtës, jo vetëm se ka rëndësi në pikëpamje artistike, por edhe pse ajo, por si vena e mirë, sa ma shumë vjet që të kalojnë aq ma vlerë merr, duke qenë se ajo është pasqyra, magazina e kopja besnike e jetës, e shpirtit, e dëshirave, e përpjekjeve, e luftës dhe vdekjes së shqiptarëve: me një fjalë, Lahuta asht shprehja më e qartë e dokeve të fshatarëve, banorëve të Maleve të Veriut. E prej se doket e lashta të fiseve malore janë gjykue të zhduken nga tallazet e forta të civilizimit, lexuesi, letrari, folkloristi, juristi e historiani i nesërm ka për t’ia ditë për nder më dhjetë a qindvjetët e ardhshëm Poetit, i cili në Lahutë të Malcis na la një ritrat të Shqiptarit, të përshkruar nga goja e

¹¹⁴ Anton Nikë Berisha, “Qasje poetikës së letërsisë gojore shqipe”, Ndërmarrja botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1998, f. 134.

¹¹⁵ Fishta, Piksime estetike mbi artin e fjalës, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003.

¹¹⁶ Po aty

dëshmitarëve njëkohorë, ashtu si këta e gjetën në agimin e shekullit XX me atë ndryshim të vogël, që shqiptari pësoi ç‘prej kohërave të largëta të iliro-trakëve”.¹¹⁷

Për Fishtën dhe krijimtarinë e tij letrare është prononcuar edhe Sejfulla Malëshovanë vitin 1945, me pseudonimin e vet Lame Kodra. Ai botoi konferencën e mbajtur më 10 qershor 1945 në Kinema – teatrin “Kosova”, me titullin: Roli i kulturës në Shqipërinë e sotme”. Në faqen 21 të këtij botimi Sejfulla Malëshova (Lame Kodra) thotë: “Kam dëgjuar, p.sh. se në disa rrethe ka tendenca që Faik Konica dhe Fishta të fshihen fare nga defteri... Koncia, Noli dhe Fishta janë fytyrat më të mbudha të Shqipërisë në fushën e kulturës. Bashkë me K. Kristoforidhin dhe Naim Frashërin ata janë leronjësit e mbëdhej të gjuhës shqipe, janë ata që kanë ngritur gjuhën shqipe në dignitetin e një gjuhe letrare... Kontributin e tyre e qujamë pjesë të pandarë të trashëgimit t’onë nacional, të pasurisë s’onë kulture”.¹¹⁸

Disa autorë e kanë shikuar shkrirjen e letërsisë gojore dhe asaj të shkruar si të pafrytshme, kurse të tjerë e kanë parë Lahutën e malësisë si një anakronizëm në shekullin XX.

Lidhur me gjuhën e veprave të Fishtës e ka dhënë mendimin e vet edhe Prof. Dr. Konrad Gjollaj (1918-2000) i cili thotë: “Në lidhje me gjuhën e veprave të Fishtës kam mendimin personal se nuk duhet të preken për asnjë arsye praktike letrare, sepse gjuha e Fishtës asht e do të mbetet gur themeltar për literaturën e ardhshme shqiptare...”¹¹⁹

Sipas Dhimitër Shuteriqit (1915-2006), Vehbi Bala (1923-1990) kishte përgatitur 40 faqe për Fishtën, që të përfshihej në historinë e letërsisë të Akademisë, por nuk e lejua ta botonte. Sipas Eqrem Çabejt (1908-1980) “Fishta qe një bir i vërtetë i polemës (popullit) të tij dhe bash nga kjo rrënjosje te trualli i vet ay u bë, në një tjetër kuptim se sa Naim Frashëri, poeti kombëtar i Shqipërisë”.¹²⁰

¹¹⁷ Kujtim M. Shala, *Shinimet e Fishtës*, AIKD, Prishtinë, 2002.

¹¹⁸ Fishta, *Piksime estetike mbi artin e fjalës*, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003.

¹¹⁹ Po aty

¹²⁰ Kujtim M. Shala, *Shinimet e Fishtës*, AIKD, Prishtinë, 2002.

Në prag të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, Fishta u njoh nga të gjithë si poet kombëtar. Albanologu austriak Maksimilian Lamberg (1882-1963) në vitin 1948 e ka cilësuar si “poetin më të talentuar që ka pasur Shqipëria”.¹²¹ Poeti italian Gabriele d’Anuncio (1863-1938) e ka quajtur Fishtën “poeti më i madh i popullit të lavdishëm të Shqipërisë”.¹²² Për të tjerë, Fishta ishte Homer shqiptar. Aleksander Xhuvani (1880-1964) e ka krahasuar Fishtën me poetin lirik grek të shekullit VII p.e.s. – Tirteun.

Pas luftës, Fishta u godit dhe u përgojua ndoshta më shumë se çdo shkrimtar tjetër i paraluftës dhe u la në harresë. Poeti kombëtar u kthye në mallkim. Historia e letërsisë shqiptare, botuar në Tiranë në vitin 1983, trajtimin të Fishtës i jepte një hapësirë të kufizuar. Në të Fishta cilësohet si poet, publicist, pedagog, politikan. Thuhet se drejtoi për një kohë të gjatë shtypin e urdhrit françeskan dhe veprimtarinë kulturore dhe arsimore të këtij urdhri.

Kryeredaktori i kësaj Historie të letërsisë shqiptare – Dhimitër Shuteriqi për Fishtën thotë: “Për të, interesat e kishës e të fesë qëndronin mbi interesat e atdheut e të popullit, gjë që ai e shpallte dhe e mbronte me tërë demagogjinë, por edhe cinizmin, dhe e kishte vënë në themel të punës së tij si letrar. Vepra e tij kryesore, poema epike Lahuta e malësisë, duke sulmuar shovinizmin e fqinjëve të veriut, propagandonte antisllavizmin dhe vinte në plan të dytë luftën kundër pushtuesit osman. Ajo i ngrinte himnin patriarkalizmit e bajraktarizmit, obskurantizmit fetar e klerikalizmit, dhe spekulonte me ndjenjat patriotike, kur ishte fjala për të ngritur lart ngjarjet dhe figurat e historisë kombëtare të periudhës së Rilindjes sonë... Ai kishte një qëndrim të theksuar konservator në lëmin e gjuhës. Fishta i mbaroi ditët si akademik i Italisë fashiste”.¹²³

Në këtë Histori të letërsisë shqiptare që përmban 629 faqe, të hartuar nga Vehbi Bala, Razi Brahimi, Klara Kodra, Ali Xhiku, Dhimitër Fullani, Shaban Çollaku, të drejtuar nga Prof. Dhimitër S. Shuteriqi (njëherazi edhe kryeredaktor) dhe të redaktuar nga nga Prof. Mahir Domi, nga Dr. Jorgo Bulo, Prof. Vebi Bala dhe nga Doc. Razi Brahimi, Fishtës i kushtohen 22 reshta.

¹²¹ Fishta, Piksime estetike mbi artin e fjalës, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003.

¹²² Po aty

¹²³ Kujtim M. Shala, Shinimet e Fishtës, AIKD, Prishtinë, 2002.

Pushteti i pasluftës katër dekada e quajti Fishtën “poet klerik e fashist”. Por, populli i Shqipërisë së veriut, e sidomos shkodranët, nuk e kishin harruar. Vepra e tij ka qarkulluar fshehurazi dorë më dorë dhe është lexuar ndër breza. Pas afro gjysmë shekulli, Gjergj Fishta u përkujtua hapur për herë të parë më 5 janar 1991 në Shkodër. Gjatë një recitimi, aktori në një çast kishte ngecur, por menjëherë dhe në mënyrë spontane u ndihmua nga salla, e cila Lahutën e malësisë ende e dinte përmendësh.

Nga figura e Gjergj Fishtës u ndikuan poetë dhe studiues françeskanë si:

- Pashko Bardhi (1870-1948),
- Shtjefën Gjeçovi (1874-1929),
- Pal Dodaj (1880-1948),
- Vinçenc Prennushi (1885-1949),
- Marin Sirdani (1885-1962),
- Anton Harapi (1888-1946),
- Justin Rrota (1889-1964),
- Bernardin Palaj (1894-1947),
- Donat Kurti (1903-1969),
- Benedikt Dema (1904-1960) dhe
- Gjon Shllaku (1907-1946).

III.4.1. A qëndron vlerësimi i Ismail Kadaresë për Lahutën e Malësisë?

Si shumë shkrimtar dhe studiue të tjerë, veprën e Fishtës në tërësi dhe në veçanti veprën e tij madhore “Lahuta e malcis” e ka komentuar dhe analizuar disa herë Kadareja, një prej shkrimtarëve më në zë të gjuhës shqipe. Sipas tij, kjo është një orvatje për të “kopjuar” Iliadën e Homerit dhe asgjë më shumë se një punim monoton i cili nuk përcjell emocione dhe aq më pak vlera artistike. Mirpo siç e pamë dhe më lart, pjesa dërrmuese e shkrimtarëve dhe studiuesve e shohin ndryshe këtë vepër. “Lahuta e Malcis” është jo vetëm një kontribut i rëndësishëm në fondin e literaturës shqipe, por një vepër e jashtëzakonshme me vlera historike, kulturore, artistike dhe filozofike e estetike. Nga kjo vepër shumë studiues të folklorit mund të nxjerrin në pah karakteristika dalluese të popullit Shqiptar mbi kulturën, artin, muzikën, kostumografinë, etj; vlera të rëndësishëm historike mund të ekstrahojnë historianët, të cilët mund të marrin këtë vepër si një pikë referimi për të studiuar ngjarjet dhe traditat e kohës.

“...një tjetër personalitet, madje më i njohuri e më i reklamuari, i kurrorëzuar si poet kombëtar, prifti Gjergj Fishta, në vetminë e kuvendit të françeskanëve po rrekej të krijonte një vepër që ishte sa jashtë kohe, aq edhe jashtë mundësive të tij. Ai orvatej të thurte poemën e madhe totale ku të mblidhte krejt eposin shqiptar në shembullin e mbledhësit mesjetar të Nibelungëve, të epeve të tjera evropiane, madje edhe më thellë, të epeve homerike. Absurde si ndërmarrje, për arsye që merreshin lehtë me mend, ajo bëhej dyfish e tillë për shkak se poetit françeskan i mungonin shumë gjëra, e në radhë të parë ai talent i veçantë për të përpunuar apo më saktë për të vënë në fre, atë shkumëzim të lirë, magjepsës e me bukuri befasuese, herë parajsore e herë infernale të eposit verior. Në vend të atij tërbimi ai nxori nga pena poemën e gjatë monotone “Lahuta e malcis”, një kronikë sterile, e cila duke qenë, veç të tjerash, moralizuese e didaktike, ngjante me epet e veriut aq sa ç’mund të ngjante ujët e distiluar me ujëvarat e bjeshkëve. Në këtë poemë, që u shpall e në të vërtetë “vepra e jetës së tij”, himnizohej Shqipëria e prapambetur, kanunore e mesjetare. Në kërkim të një të vërtete të përjetshme të kombit, çka do të kushtëzonte dhe universalizmin e pretenduar prej tij në poezi, ai nuk shkoi më tej konfliktit ndëretnik midis shqiptarëve e sllavëve, që e shpalli si një luftë gati kozmogonike...”

Në kritikën e Kadaresë mbivlerësohet karakteri patriotik i Fishtës, duke lënë anash faktin se ai qe një poet i madh.

...Ndeshja sllavo-shqiptare kishte qenë dhe vazhdonte të ishte e egër dhe se eposi shqiptar vazhdonte të këndonte kundër sllavëve edhe pse shqiptarët kishin armikun e ri – osmanët. Nuk i lejohej një poeti, e aq më tepër një poeti të shekullit XX, që të mos shihet në këtë kob asnjë dritë e asnjë rrugë pajtimi, madje as aq dritë sa jepte herë-herë vetë eposi zemrak. Aq më pak nuk i lejohej një poeti që duke dhënë tablo tronditëse të kësaj ndeshjeje dhe duke u revoltuar me të ndaj padrejtësive që i qenë bërë e vazhdonin t’i bëheshin kombit shqiptar, të mos bënte, megjithatë, një dallim midis popujve sllavë dhe shovinizmit sllavomadh e sidomos serbomadh... Mesazhin racionalist të Fishtës, mesazh që herë-herë merrte përmasat e një ksenofobie totale e që synonte izolimin e plotë të Shqipërisë prej botës së jashtme, nuk e përfilli as letërsia e as mendësia shqiptare...”¹²⁴

Lidhur me Lahutën e malësisë Kadareja ka dhënë vlerësime disa herë. Mund të përmenden vlerësimet në vitet 1988 dhe 1991:

“Mirëpo kësaj vepre artificiale, që ishte veç të tjerash një manifest reaksionar, idealizimit të Shqipërisë së prapambetur, kanunore e mesjetare, iu bë një reklamë e tillë, sa që rrezikonte ta kthente atë në një gur varri që mund t’i merrte frymën gjithë letërsisë shqipe. Dukuri jo fort të shpeshta, vepra të tilla (të një autori, të një grupi autorësh ose të një drejtimi letrar) qëllon që shfaqen në letërsi të ndryshme, tamam si sëmundje, që duhen kapërcyer. Për fat të mirë, letërsia shqipe u çlirua më shpejtë se ç’pritej nga ky keqkuptim e nga ky ankth”.¹²⁵

Tre vjet më vonë lidhur me Lahutën e malësisë Kadare thotë:

“Në të vërtetë, me gjithë mosqasjen e ftohtësinë që treguan për të shkrimtarët e intelektualët e shquar shqiptarë, veprës së Fishtës, sidomos Lahutës së malësisë, iu ngrit një kult e iu bë

¹²⁴ Kujtim M. Shala, *Shinimet e Fishtës*, AIKD, Prishtinë, 2002.

¹²⁵ Shkrimi do të citohet sipas Faik Konica, *Vepra 1*, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, *Botimet Dudaj*, Tiranë, 2001

një reklamë e tillë, saqë rrezikonte ta kthente atë në një gur varri që mund t'i merrte frymën gjithë letërsisë shqipe. Dukuri jo fort të shpeshta, vepra të tilla (të një autori, të një grupi autorësh ose të një drejtimi letrar) qëllon që shfaqen në letërsi të ndryshme, tamam si sëmundje, që duhen kapërcyer. Për shkaqe e rrethana jashtëletrare (çlirimi i vendit nga fashizmi, përmbysja shoqërore etj.), u çlirua më shpejtë se ç'pritej nga ky keqkuptim".¹²⁶

Mirëpo, në takimin me studentët, lidhur me vlerësimet e tij për Fishtën dhe për Lahutën e malësisë, Kadareja thotë: "...mbase mund ta kem gabim".¹²⁷ Duhet shtuar po ashtu se kadareja ka thënë: "Fishta nuk do të dalë kurrë mbi Naimin, as Konica mbi Nolin"¹²⁸

E megjithatë siç e cekëm dhe më lart, ky vlerësim i Kadaresë, i cili është vënë shumë herë në diskutime, nuk është një e vërtetë e patjetërsueshme, përkundrazi. Nëse vepra e Fishtës, do të ishte një përpjekje, monotone, artificiale, ajo jo vetëm do të venitej me kohën, por as më të voglat përpjekje për shpërndarjen e saj nëpër botë nuk do të ndërmerreshin. "Lahuta e Malcis" është botuar në diasporë që mbas 1950-tës, fillimisht në Romë në revistën letrare "Shenjzat", me këngë dhe pjesë të shkurtëra të përkthyer nga Koliqi, në editorialet Kosovare, më vonë u përkthye në gjermanisht nga albanologu i njohur Maks Lambertz, etj. Me daljen në dritë të saj në gjuhën Italiane në 1974 nga albanologu arbëresh Ignazio Parrino. Atëherë si asht e mujtun që u banë kaq përpjekje që në këto vite të vështira për gjuhën shqipe dhe Shqiptarët për me mbajt gjallë këtë vepër?

Gjithashtu vlen të shtojmë se jo vetëm atëherë është shkruar pa fund për Fishtën nga shkrimtarë e studiues ku më në zë ishte studiuesi Arshi Pipa, i cili njëkohësisht ka bërë shumë përkthime të Fishtës në gjuhën angleze, por edhe sot e kësaj dite Fishta studiohet njëjtë.

Fishta si figurë e shkëlqyer e letërsisë dhe kulturës shqiptare ka qënë dhe është gjithnjë në qendër të vëmëndjes së shkencës në të gjithë qendrat universitare albanologjike në të gjithë botën. Mbi

¹²⁶ Po aty

¹²⁷ Po aty

¹²⁸ Shkrimi do të citohet sipas Faik Konica, Vepra 1, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001.

veprat dhe vlerat e tij janë shkruar dhjetëra punime shkencore, teza diplomimi apo doktoratura. Fishta është bërë prej shumë kohësh tashmë pjesë e korposit botëror, veçanërisht në studimet monografike specifike rreth epikës botërore, duke qenë se në këtë gjini letrare poeti ynë zë vënd të veçantë. Madje diku pata lexu që “Lahuta e Malcis” mbahet si vepra e fundit epike në kontinentin tonë.

Nisur nga ky studim, rruga për deri tek këto rreshta ka formuar tek unë një tjetër mendim nga ai i Kadaresë për Fishtën, sigurisht që ky studim nuk ka për qëllim të fokusohet në një kundërvënie të fjalëve të Kadaresë, po ku më mirë se këtu mund të japësh pa fund argumenta kundër, që hedhin poshtë çdo fjalë keqdashëse mbi figurën e Fishtës dhe veprën e tij. Si Kadareja Fishta ka hasur plot edhe në kohë të tij:

Ti ke mbajtur

Gjithmonë këtë rregull:

Erzin e shpirtin

Do t’losish shregull

Do t’i shesish vllazent,

Do t’ mohojshe fisin,

Sá herë qi n’ shekull

T’a leverdisin

(Anzat e Parnasit)

Po sot, paçka mendimeve kundër vlerave të Fishtës është koha ta zbërthejmë gërshetimin kompleks të veprës së tij, mes epikës, lirikës, ironisë, satirës e estetikës. Është koha të fillojmë të zbulojmë fillin e jo vetëm një periudhe në veprën “Lahuta e Malcis”, por të mbarë traditës shqiptare. Ai pa dyshim ka kontribut të paçmuar në lidhjen e traditës letrare gojore popullore, një traditë kjo mijëravjeçar me letërsinë reflekse apo individuale të shkruar.

IV. PËRFUNDIME

Duke përfunduar këtë studim për konceptet estetike, poetike dhe kritike të Gjergj Fishtës, mund të gjykojmë:

- Fishta hyn në radhën e shkrimtarëve të paktë shqiptarë të kohës së vet dhe të traditës që ka mëtuar të krijojë një traktat origjinal estetik, të shkruar në shkrimin Shinime estetike: mbi natyrë t'Artit (1933). Ky shkrim i Fishtës dhe shumë mendime estetike të shfaqura në shkrime të diskurseve të ndryshme e në letra private, janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për të kuptuar mendimin estetik dhe kritik letrar të poetit tonë, por edhe për studimin e mendimit estetik e kritik letrar shqiptar;
- konceptet estetike të Fishtës nuk paraqesin një sistem unik dhe origjinal të mendimit estetik, sado ka disa studiues, të cilët nga dëshira të mira pretendojnë këtë shkallë të zhvillimit të mendimit estetik të Fishtës;
- në konceptet estetike të Fishtës ai vazhdon mësimet estetike të Shën Augustinit, i cili nga ana e tij ishte i ndikuar thelbësisht nga esteti pagan Plotini, ndërsa e ndikoi fuqimisht filozofin dhe estetin krishter mesjetar Shën Thoma Akuinin (1225-1274)⁴⁹⁶, duke i përafëruar ato me disa mësimet të Renesancës italiane për botën e pavarur të veprës artistike e deri te mendimi estetik i Hegelit për gjenium krijues, për të bukurën subjektive dhe për punën që bën poeti, rikrijimin, me të cilën afrohet apo imiton zotin që ka krijuar natyrën e kozmosin;
- duke paraqitur koncepte të shkollave të ndryshme estetike, Fishta i ka harmonizuar (përkundër disa kundërshtive të vogla) në një tërësi kohezive në mënyrë origjinale, sado nuk mund të flasim për një sistem origjinal, siç pretendojnë Aurel Plasari, Kujtim M. Shala e ndonjë tjetër.
- Rëndësia e këtyre koncepteve qëndron në teorinë e dy Rruzullimeve, e që është ekzistimi i botës së pavarur të veprës letrare, e cila edhe pse është brenda botës reale, nuk është pjesë e botës reale. Kjo teori, e vjetër së pakut që nga Humanizmi dhe Renesanca evropiane (Filip Sidni) është shumë interesante për mendimin estetik dhe kritik letrar shqiptar, sepse e ndanë veprën letrare nga bota tjetër, arti shndërrohet në botë më vete, në qendër, veprimtari e përafërt me atë të zotit kur ka krijuar rruzullimin etj. Kjo teori, pra, është e rëndësishme, sepse vë artin e letërsinë në qendër të botës, e që si filozofi është botëkuptim i Hegelit, i

cili për herë të parë në historinë e njerëzimit vuri estetikën dhe kuptimet estetike në themelin e filozofisë së vet, ndërsa si koncept estetik është romantik;

- duke qenë tradicionalist edhe në konceptet estetike dhe në mendimin kritik Fishta rri afër poetëve të rrethit letrar shkodran, por rri larg De Radës e Naim Frashërit nga tradita dhe edhe më larg nga Faik Konica në bashkëkohësi.

V. LITERATURA

1. Aliçkaj, Dr. Xhavit, Lahuta e Malcisë e Gjergj Fishtës, Faik Konica, Prishtinë, 2000.
2. Aurel Plasari , Fishta – estetikë dhe kritikë, në, Hylli i Dritës, Tiranë 1999.
3. Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992.
4. Lek Pervizi, Mbi Gjergj Fishten, Revista Kuq e Zi, Nr. 44-45, 2010.
5. Stefan Çapaliku, At Gjergj Fishta, Shkodër 1993.
6. Stefan Çapaliku, Historia e letërsisë si grindje metodike, Studime shqiptare 2. Shkodër 1995.
7. Lahuta e malësisë, Botimi i tretë, Romë 1991, 525 faqe, botuar nga Qendra e Katolikëve Shqiptarë Jashtë Atdheut.
8. Gjergj Fishta, Lahuta e malcis Sh. b. “Faik Konica”, Prishtinë 2000.
9. Injac Zamputi, Fishta, koha, njeriu, vepra, Tiranë 1993, Sh.b. “Pasqyra”.
10. Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997.
11. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botim i ri, Tiranë 2008, I-III; Vëllimi I.
12. Pjetër Jaku, Vlerat letrare në Lahutën e malësisë të Gjergj Fishtës, Lezhë 2000, Sh.b. Kuvendi.
13. Vehbi Bala, Gjergj Fishta, Jeta dhe vepra, Tiranë, Ombra, GVG, 1998.
14. Viktor Volaj, Parathanje.
15. FISHTA, GJERGJ, Estetikë dhe kritikë, (antologji e përgatitur nga Persida Asllani), Hylli i dritës dhe Shtëpia e librit, (pa datë dhe pa vend të botimit).
16. FISHTA, GJERGJ, Piksime estetike mbi artin e fjalës, (antologji e shkrimeve estetike të Fishtës, përgatitur dhe përcjellë me një parathënie nga Anton Nikë Berisha), Shpresa, Prishtinë, 2003.
17. FISHTA, GJERGJ, Përndritje, publicistikë, (përmbledhje e shkrimeve publicistike, të redaktuara nga Ilir Nikolla), Lajmëtari 2000, Tiranë, 2000.
18. Ndiriçim Kulla & Dritan Thomollari, “Etika dhe Iluminimi-Skicë për një manifest të jetës intelektuale”, “Plejad”, Tiranë, 1995.

19. Ardian Ndreca, “Idea dhe realizimi i bashkësisë qytetare shqiptare”, në “Hylli i Dritës”, nr. 2, v. 2007.
20. Benedeto Kroçe, “Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme”, “Apollonia”, Tiranë, 1998.
21. Anton Harapi, “Kulla e Babelit”, Përgatitur nga Dr. Aurel Plasari. “Phoenix–Shtëpia e librit”, Tiranë, 1999.
22. Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqiptare, Romantizmi II, Rilindja, Prishtinë, 1984.
23. Sabri Hamiti, Studime letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003.
24. Benedikt Dema, Gjergj Fishta, jeta dhe vepra, Romë 1992.
25. Flori Bruçi, “Gjergj Fishta: Jeta dhe vepra” (1871-1940).
26. Aurel Plasari, Fishta meditans, parathënie në librin Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli I Dritës & Shtëpia e librit, Tiranë, 1999.
27. Vehbi Bala, Gjergj Fishta, Jeta dhe vepra, Tiranë, Ombra, GVG, 1998.
28. Hylli i Dritës, 1933, nr. 1.
29. Hylli i Dritës, 1932, nr. 7 – 8.
30. Hylli i Dritës, 1913, nr. 3.
31. Hylli i Dritës, 1930, nr. 12.
32. Hylli i Dritës, 1933, nr. 4.
33. Hylli i Dritës, 1935, nr. 4.
34. Hylli i Dritës, 1923, nr. 3.
35. Hylli i Dritës, 1924, nr. 1.
36. Hylli i Dritës, 1932, nr. 12.
37. Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983.
38. Fishta, Piksime estetike mbi artin e fjalës, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003.
39. Gilbert-Kun, Istorija estetike, Kultura.
40. Shih për afërsinë e neoplatonistëve me krishterimin në librin Rrëfimet të Shën Augustinit, Plejad, Tiranë, 2006.
41. Samuel E. Stumpf, Filozofia-historia dhe problemet, Botimet Toena, Tiranë.
42. Horaci, Arti Poetik, përkthyer prej Dr. Engjëll Sedaj, Buzuku, Prishtinë.

43. Platoni, Shteti, Libri III; shih edhe S. E. Stumpf, Filozofia-historia dhe problemet, Botimet Toena, Tiranë.
44. A. N. Berisha, Pikësime estetike mbi artin e fjalës, Shpresa, Prishtinë, 2003.
45. Kujtim M. Shala, Shinimet e Fishtës, AIKD, Prishtinë, 2002.
46. Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit.
47. De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, Rilindja, Prishtinë, 1988.
48. Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983.
49. Shkrimi do të citohet sipas Faik Konica, Vepra 1, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001.
50. Zejnullah Rrahmani, Probleme të metodës në shkrimin historiko-letrar, në Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë, 1996.
51. Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 236 dhe fusnota 20.
52. Meshari i Gjon Buzukut, botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e dytë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968.
53. Umberto Eko thotë: “Ka qytetërime, i pari nga të gjithë qytetërimi anglosakson, ku-të paktën deri në ardhjen e New Criticism-it- biseda rreth veprave letrare ishte para së gjithash ishte bisedë morale”. Shih te libri Për letërsinë, Dituria, 2007.
54. Gjergj Fishta, Përndritje/publicistikë.
55. Eqrem Çabej, “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, shtëpia botuese “MÇM”, Tiranë, 1994.
56. M. Edith Durham, “Twenty Years of Balkan Tangle” Londër, 1920, f. 124. Cituar nga Faik Konica, “Vepra”.
57. Paul Edmonds, “To the Land of the Eagle”, Londër, 1927, f. 78. Cituar sipas Faik Konica, “Vepra”.

58. ALIÇKAJ, Xhavit. “Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës” Studim monografik. – Prishtinë, Faik Konica, 2000.
59. BALA, Vehbi. “Gjergj Fishta : Jeta dhe vepra Shkodër, 1961”. – Tiranë, Shtëpia e Librit OMBRA GVG“, 1998.
60. ÇEFA, Kolec. “Nëpër gjurmët e Fishtës.”, Shkodër, ShB Françeskane, 2003.

- 61 ÇOBANI, Tonin. “Miti dhe antimiti fishtjan : Dhjetë ese”, Lezhë, Lisitan, 1999.
- 62 DAIJA, Tonin. “Fjala, tingulli, metrika në “Lahutën e Malcis””, Shkodër, Botime Françeskane, 2004.
- 63 DEMA, Benedikt. “Fjalori historik i veprës “Lahuta e Malcis””, [dorëshkrim]. Shkodër, 1945.
- 64 Gjergj Fishta, “Piksime estetike mbi artin e fjalës”, me një punim hyrës nga Anton Nikë Berisha. Prishtinë, Shpresa, 2003.
- 65 HAMITI, Sabri. let. “Letërsia moderne shqipe”. Tiranë, 2009.
- 66 KOLIQUI, Ernest. “Kritikë dhe estetikë / përg. Stefan Çapaliku”, Tiranë, Apolonia, 1999.
- 67 KOLIQUI, Ernest. “Fishta interpret i shpirtit shqiptar”, Gjakovë. Kuvendi Françeskan, 1997.
- 68 KOLIQUI, Ernest. “Vepra 5 : Shkrime kritike”, Prishtinë, Faik Konica, 2003.
- 69 KRASNIQI, Nysret. “Rrëfimi dhe shkrimi: Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës” – Prishtinë, AIKD, 2003.
- 70 RESULI, Kapllan. “Fishta dhe të tjerë”, Tiranë, Naum Veqilharxhi, 2001.
- 71 RUGOVA, Ibrahim. [Gjergj Fishta]. Në: I. Rugova, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504 – 1983”, Prishtinë, Rilindja, 1986.
- 72 RROTA, Justin. “At Gjergj Fishta O.F.M” Në: J. Rrota, Letratyra shqype. Shkodër, Shtypshkroja Françiskane, 1925.
- 73 SUTA, Blerina. “Eposi i At Gjergj Fishtës përballë eposeve të shkrimtarëve romantikë sllavojugorë”, Tiranë, Onufri, 2007.
- 74 SHALA, Kujtim M. “Fishta - nga shkrimi te metashkrimi”, Filologji, Prishtinë. - Nr. 11, 2003.
- 75 SHALA, Kujtim M. “Fishta përballë Fishtës”. Prishtinë, Gjon Buzuku, 2004.
- 76 SHALA, Kujtim M. “Shinimet e Fishtës”. – Prishtinë. AIKD, 2002.
- 77 SHANTOJA, Lazër : “Vepra”, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.
- 78 ZAMPUTI, Injac. “Fishta: koha, njeriu, vepra”. Tiranë, Pasqyra, 1993.